



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

Nr. 164 i Vendimit

V E N D I M

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

**Sokol Sadushi
Ervin Pupe
Ilir Panda**

**Kryesues
Anëtar
Anëtar**

Në datën 18.05.2020, mori në shqyrtim në dhomën e këshillimit çështjen administrative, që u përket palëve:

KËRKUES: Drejtoria e Përgjithshme Nr.1 e Punëtorëve të Qytetit

OBJEKTI: Pezullimi i ekzekutimit të vendimit nr.2410, datë 17.09.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë dhe vendimit nr.466, datë 09.02.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

BAZA LIGJORE: Neni 479 të Kodit të Procedurës Civile

Në çështjen me palë:

PADITËS: Astrit Loka

PADITUR: Drejtoria e Përgjithshme Nr.1 e Punëtorëve të Qytetit

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoji relacionin e gjyqtarit Sokol Sadushi dhe diskutoi çështjen në tërësi në dhomën e këshillimit,

VËREN

I- RRETHANAT E ÇËSHTJES

1- Nga aktet e administruara në praktikën gjyqësore, rezulton se pala paditëse Astrit Loka, ka punuar pranë palës së paditur Drejtoria e Përgjithshme Nr.1 e Punëtorëve të Qytetit, në pozicionin e “punëtor gjelbërimi”.

2- Nga ana e palës së paditur Drejtoria e Përgjithshme Nr.1 e Punëtorëve të Qytetit, është ristrukturuar organikën e saj dhe si pasojë, ka rezultuar se pozicioni i punës së palës paditëse është suprimuar dhe në këto kushtet është ndërprerë marrëdhënia e punës.

3- Për sa më sipër, paditësi duke pretenduar se pala e paditur ka vepruar në kundërshtim me ligjin, i është drejtuar gjykatës me padinë objekt gjykimi.

4- **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë**, me vendimin nr.466, datë 09.02.2016 ka vendosur:

Pranimin e pjesshëm të kërkesë padisë së paditësit Astrit Loka.

Detyrimin e palës së paditur Bashkia Tiranë, Drejtoria e Punëtorëve Nr.1, të dëmshpërblejë paditësin Astrit Loka me pagën e 6 muajve, për zgjidhje të menjëhershme të pajustificuar të kontratës së punës.

Detyrimin e palës së paditur Bashkia Tiranë, Drejtoria e Punëtorëve Nr.1, të dëmshpërblejë paditësin Astrit Loka me pagën e 2muajve, për mosrespektim të afatit të njoftimit.

Rrëzimin për pjesën tjetër të kërkesë padisë.

5- **Gjykata Administrative e Apelit Tiranë**, me vendimin nr.2410, datë 17.09.2019 ka vendosur:

Lënien në fuqi të vendimit nr.466, datë 09.02.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

6- Më datë **08.01.2020** Drejtoria e Përgjithshme Nr.1 e Punëtorëve të Qytetit, ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në thelb parashtron sa vijon:

- *Vendimi i dhënë nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë është marrë në zbatim të gabuar të ligjit dhe në shkelje të normave procedurale.*
- *Pala e paditur ka provuar përpara gjykatës respektimin e afatit të njoftimit për zgjidhjen e kontratës së punës sipas nenit 143 të Kodit të Punës, pasi paditës është njoftuar për zgjidhje e kontratës në zbatim të vendimit të Këshillit Bashkiak nr.41 datë 23.09.2015 “Për riorganizimin e Drejtoria e Përgjithshme Nr.1 e Punëtorëve të Qytetit...” ku nga 560 punëtor do të bëhen 360.*
- *Gjykata ka vendosur gabim kur ka dëmshpërblyer paditësin, pasi pushimi ka qenë për shkaqe të justifikuara dhe në mënyrë të menjëhershme, sepse punëdhënësi ka qenë i detyruar për të zbatuar organikën e re, në zbatim edhe të vendimit unifikues të Gjykatës së Lartë nr.19 datë 15.11.2017.*

Ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda dhe të pariparueshme.

II- VLERËSIMI I KOLEGJIT ADMINISTRATIV TË GJYKATËS SË LARTË

7- Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28

e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

8- Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atëçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

9- Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:

a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme; dhe/ose

b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.

10- Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- *ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të pariparueshëm dhe të atëçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;*
- *(nuk) cenohet rëndë interesi publik.*

11- Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të inicuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

12- Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar

dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentat e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim.

13- Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim. Nga ana tjetër abuzimi me mjetin ligjor të parashkuar nga neni 479 i Kodit të Procedurës Civile mund të shkaktojë dhe aktivizimin e përgjegjesisë personale pasurore të palës apo përfaqësuesit, sipas pikës 1 të nenit 34 të Kodit.

14- Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në funksion të zgjidhjes së çështjes konkrete, vlerëson se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë e paraqitur nga pala e paditur, Drejtoria e Përgjithshme Nr.1 e Punëtorëve të Qytetit, është e pabazuar në ligj dhe si e tillë nuk duhet të pranohet.

15- Ky Kolegj vëren se, në zbatim të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, bashkëlidhur kërkesës për pezullim të palës kërkuese Drejtoria e Përgjithshme Nr.1 e Punëtorëve të Qytetit, gjendet edhe kopja e rekursit të ushtruar nga kjo palë kundër vendimit gjyqësor që kërkohet të pezullohet ekzekutimit.

16- Gjithashtu, ky Kolegj vëren se palët e tjera pjesëmarrëse në gjykimin e çështjes ku është dhënë vendimi gjyqësor që kërkohet të pezullohet, janë njoftuar rregullisht për kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese Drejtoria e Përgjithshme Nr.1 e Punëtorëve të Qytetit, të cilat nuk kanë parashtruar argumente lidhur me bazueshmërinë në ligj të kërkesës për pezullim dhe për qëndrimin e tyre.

17- Nga shqyrtimi i shkaqeve konkrete për të cilat pala kërkuese Drejtoria e Përgjithshme Nr.1 e Punëtorëve të Qytetit kërkon pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, Kolegji Administrativ vlerëson se, kjo Kërkesë, në tërësinë e saj, motivohet me shkaqe që kanë të bëjnë vetëm me drejtësinë, bazueshmërinë në prova dhe në ligj, të vendimeve të dhëna nga gjykata administrative e shkallës së parë dhe ajo e Apelit në zgjidhjen e çështjes, të cilat ky Kolegj i vlerëson në kohën kur shqyrton në dhomë këshillimi shkaqet e rekursit ndaj vendimit të gjykatës administrative të apelit.

18- Për sa i përket motivit të fundit dhe të vetëm, që formalisht përfshihet në rastin e shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, Kolegji Administrativ vëren se pala kërkuese Drejtoria e Përgjithshme Nr.1 e Punëtorëve të Qytetit nuk ka paraqitur asnjë provë dhe nuk ka arsyetuar lidhur me ndonjë rrethanë konkrete për ta vlerësuar nëse jemi ose jo përpara rastit kur Gjykata e Lartë mund të konkludojë se nga ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit gjyqësor do të vinin pasoja të rënda financiare për palën kërkuese Drejtoria e Përgjithshme Nr.1 e Punëtorëve të Qytetit.

19- Kolegji Administrativ vlerëson të evidentojë se, duke mbajtur parasysh edhe natyrën e mosmarrëveshjes mes palëve, pozitën e palës kreditore dhe asaj debitore, si edhe natyrën dhe vlerën e detyrimeve që kërkohet të ekzekutohen në çështjen konkrete në shqyrtim, në interpretim dhe zbatim të drejtë të ligjit procedural, mbetet thjesht një kërkim dhe pretendim hipotetik dhe, si i tillë, i pambështetur në ligj, vetëm parashtrimi formal i pretendimit (shkakut) se ekzekutimi mund të sjellë pasoja të rënda financiare, si një shkak që

e përcakton vetë neni 479 pika 1 shkronja “a” e Kodit të Procedurës Civile, pa parashtruar njëkohësisht edhe argumenta dhe shpjegime konkrete lidhur me rrethanat që tregojnë mundësinë e ardhjes së tyre.

20- Për sa më sipër, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se nuk ka vend për të pranuar kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese Drejtoria e Përgjithshme Nr.1 e Punëtorëve të Qytetit, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.2410, datë 17.09.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë dhe vendimit nr.466, datë 09.02.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në bazë të nenit 1 pika 2 e ligjit nr.49/2012 “Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative” dhe nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile

V E N D O S I

Mospranimin e kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.2410, datë 17.09.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë dhe vendimit nr.466, datë 09.02.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme Nr.1 e Punëtorëve të Qytetit.

Tiranë, më datë 18.05.2020

**ANËTAR
ERVIN PUPE**

**ANËTAR
ILIR PANDA**

**KRYESUES
SOKOL SADUSHI**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

Nr.165 i Vendimit

V E N D I M

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

**Sokol Sadushi
Ervin Pupe
Ilir Panda**

**Kryesues
Anëtar
Anëtar**

Në datën 18.05.2020, mori në shqyrtim në dhomën e këshillimit çështjen administrative, që u përket palëve:

KËRKUES: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

OBJEKTI: Pezullimi i ekzekutimit të vendimit nr.2857, datë 31.10.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

BAZA LIGJORE: Neni 479 të Kodit të Procedurës Civile

Në çështjen me palë:

PADITËS: Medi Brahilika

PADITUR: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoji relacionin e gjyqtarit Sokol Sadushi dhe diskutoi çështjen në tërësi në dhomën e këshillimit,

VËREN

I- RRETHANAT E ÇËSHTJES

1- Nga aktet e administruara në praktikën gjyqësore, rezulton se pala paditëse Medi Brahilika, është ndaluar nga Policia e Shtetit për akuzën e “Vjedhje të energjisë elektrike dhe

impulseve elektronike” dhe nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë i është dhënë masa e arrestit në shtëpi.

2- Për akuzën e sipërcituar Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur ta deklaroj fajtor palën paditëse, për veprën penale që i atribuohet, vendim ky i cili është prishur nga Gjykata e Apelit Tiranë e cila ka vendosur mospranim ankimi pasi pala paditëse hoqi dorë nga ankimi.

3- Për sa më sipër, paditësi duke pretenduar se ka kryer burgim të padrejtë dhe i është drejtuar gjykatës me padinë objekt gjykimi.

4- **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë**, me vendimin nr.403, datë 12.02.2018 ka vendosur:
Pranimin e kërkesë padisë së paditësit Medi Brahilika.
Detyrimin e palëve të paditur të kompensojnë paditësin Medi Brahilika për ditët e qëndrimit në mënyrë të padrejtë në kushtet e masës së sigurimit personal “arrest në shtëpi” për periudhën 20.08.2016-20.09.2017, konkretisht 13 muaj x 22.000 lekë/muaj = 286.000 (dyqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë) lekë.

5- **Gjykata Administrative e Apelit Tiranë**, me vendimin nr.2857, datë 31.10.2019 ka vendosur:
Lënien në fuqi të vendimit nr.403, datë 12.02.2018 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

6- Më datë **09.01.2020** Ministria e Financave dhe Ekonomisë, ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në thelb parashtron sa vijon:

- *Vendimi është i gabuar dhe i pabazuar në ligj, pasi nuk është respektuar dhe nuk është zbatuar drejtë ligji.*
- *Gjykatat kanë gabuar në caktimin e masës së kompensimit për paditësin, pasi nuk justifikohet caktimi i masës në prova konkrete.*
- *Gjykata duhet të hetojë çështjen dhe të administrojë prova, në lidhje me aspektet e dispozitës materiale, duke ia nënshtruar parimit të provueshmërisë, mbështetur në nenin 12 të K.Pr.Civile ku përcaktohet se paditësi ka barrën e provës.*
- *Ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda financiare për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.*

II- VLERËSIMI I KOLEGJIT ADMINISTRATIV TË GJYKATËS SË LARTË

7- Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

8- Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atëçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të riparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

9- Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:

a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të riparueshme; dhe/ose

b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.

10- Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- *ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të riparueshëm dhe të atëçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;*
- *(nuk) cenohet rëndë interesi publik.*

11- Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të inicuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

12- Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentat e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim.

13- Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim. Nga ana tjetër abuzimi me mjetin ligjor të parashikuar nga neni 479 i Kodit të Procedurës Civile mund të shkaktojë dhe aktivizimin e përgjegjësive personale pasurore të palës apo përfaqësuesit, sipas pikës 1 të nenit 34 të Kodit.

14- Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në funksion të zgjidhjes së çështjes konkrete, vlerëson se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë e paraqitur nga pala e paditur, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, është e pabazuar në ligj dhe si e tillë nuk duhet të pranohet.

15- Ky Kolegj vëren se, në zbatim të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, bashkëlidhur kërkesës për pezullim të palës kërkuese Ministria e Financave dhe Ekonomisë, gjendet edhe kopja e rekursit të ushtruar nga kjo palë kundër vendimit gjyqësor që kërkohet të pezullohet ekzekutimit.

16- Gjithashtu, ky Kolegj vëren se palët e tjera pjesëmarrëse në gjykimin e çështjes ku është dhënë vendimi gjyqësor që kërkohet të pezullohet, janë njoftuar rregullisht për kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese Ministria e Financave dhe Ekonomisë, i cili kanë parashtruar argumente lidhur me mos bazueshmërinë në ligj të kërkesës për pezullim dhe në thelb të qëndrimit të tij ka kërkuar mospranimin e kërkesës si të pabazuar në ligj.

17- Nga shqyrtimi i shkaqeve konkrete për të cilat pala kërkuese Ministria e Financave dhe Ekonomisë kërkon pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, Kolegji Administrativ vlerëson se, kjo Kërkesë, në tërësinë e saj, motivohet me shkaqe që kanë të bëjnë vetëm me drejtësinë, bazueshmërinë në prova dhe në ligj, të vendimeve të dhëna nga gjykata administrative e shkallës së parë dhe ajo e Apelit në zgjidhjen e çështjes, të cilat ky Kolegj i vlerëson në kohën kur shqyrton në dhomë këshillimi shkaqet e rekursit ndaj vendimit të gjykatës administrative të apelit.

18- Për sa i përket motivit të fundit dhe të vetëm, që formalisht përfshihet në rastin e shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, Kolegji Administrativ vëren se pala kërkuese Ministria e Financave dhe Ekonomisë nuk ka paraqitur asnjë provë dhe nuk ka arsyetuar lidhur me ndonjë rrethanë konkrete për ta vlerësuar nëse jemi ose jo përpara rastit kur Gjykata e Lartë mund të konkludojë se nga ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit gjyqësor do të vinin pasoja të rënda financiare për palën kërkuese Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

19- Kolegji Administrativ vlerëson të evidentojë se, duke mbajtur parasysh edhe natyrën e mosmarrëveshjes mes palëve, pozitën e palës kreditore dhe asaj debitore, si edhe natyrën dhe vlerën e detyrimeve që kërkohet të ekzekutohen në çështjen konkrete në shqyrtim, në interpretim dhe zbatim të drejtë të ligjit procedural, mbetet thjesht një kërkim dhe pretendim hipotetik dhe, si i tillë, i pambështetur në ligj, vetëm parashtrimi formal i pretendimit (shkakut) se ekzekutimi mund të sjellë pasoja të rënda financiare, si një shkak që e përcakton vetë neni 479 pika 1 shkronja “a” e Kodit të Procedurës Civile, pa parashtruar njëkohësisht edhe argumenta dhe shpjegime konkrete lidhur me rrethanat që tregojnë mundësinë e ardhjes së tyre.

20- Për sa më sipër, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se nuk ka vend për të pranuar kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese Ministria e Financave dhe Ekonomisë,

për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.2857, datë 31.10.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në bazë të nenit 1 pika 2 e ligjit nr.49/2012 “Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative” dhe nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile

V E N D O S I

Mospranimin e kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.2857, datë 31.10.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, të paraqitur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Tiranë, më datë 18.05.2020

**ANËTAR
ERVIN PUPE**

**ANËTAR
ILIR PANDA**

**KRYESUES
SOKOL SADUSHI**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

Nr. 180 i Vendimit

V E N D I M

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

**Sokol Sadushi
Ervin Pupe
Irir Panda**

**Kryesues
Anëtar
Anëtar**

Në datën 18.05.2020, mori në shqyrtim në dhomën e këshillimit çështjen administrative, që u përket palëve:

KËRKUES: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

OBJEKTI: Pezullimi i ekzekutimit të vendimit nr.2424, datë 17.09.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë dhe vendimit nr.2603, datë 12.06.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

BAZA LIGJORE: Neni 479 të Kodit të Procedurës Civile

Në çështjen me palë:

PADITËS: Gentian Subashi

PADITUR: Ministria e Financave dhe Ekonomisë etj

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoi relacionin e gjyqtarit Sokol Sadushi dhe diskutoi çështjen në tërësi në dhomën e këshillimit,

VËREN

I- RRETHANAT E ÇËSHTJES

1- Nga aktet e administruara në praktikën gjyqësore, rezulton se pala paditëse Gentian Subashi, është ndaluar nga Policia e Shtetit dhe nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë i është dhënë masa e arrestit në burg.

2- Për sa më sipër, paditësi duke pretenduar se ka kryer burgim të padrejtë dhe i është drejtuar gjykatës me padinë objekt gjykimi.

3- **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë**, me vendimin nr.2603, datë 12.06.2017 ka vendosur:

Pranimin e kërkesë padisë së paditësit Gentian Subashi.

Kompensimin për burgim të padrejtë të paditësit Gentian Subashi për 36 ditë paraburgim.

Detyrimin e palëve të paditura Ministria e Financave dhe Dega e Thesarit Tiranë për të kompensuar paditësin Kujtim Subashi në shumën 39 000 lekë.

4- **Gjykata Administrative e Apelit Tiranë**, me vendimin nr.2424, datë 17.09.2019 ka vendosur:

Lënien në fuqi të vendimit nr.2603, datë 12.06.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

5- Më datë **30.01.2020** Ministria e Financave dhe Ekonomisë, ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në thelb parashtron sa vijon:

- *Vendimi është i gabuar dhe i pabazuar në ligj, pasi nuk është respektuar dhe nuk është zbatuar drejtë ligji.*
- *Gjykatat kanë gabuar në caktimin e masës së kompensimit për paditësin, pasi nuk justifikohet caktimi i masës në prova konkrete.*
- *Gjykata duhet të hetojë çështjen dhe të administrojë prova, në lidhje me aspektet e dispozitës materiale, duke ia nënshtruar parimit të provueshmërisë, mbështetur në nenin 12 të K.Pr.Civile ku përcaktohet se paditësi ka barrën e provës.*
- *Ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda financiare për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë..*

II- VLERËSIMI I KOLEGJIT ADMINISTRATIV TË GJYKATËS SË LARTË

6- Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

7- Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

8- Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:

a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme; dhe/ose

b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.

9- Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- *ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të pariparueshëm dhe të atëçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;*
- *(nuk) cenohet rëndë interesi publik.*

10- Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të inicuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

11- Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentat e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim.

12- Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim. Nga ana tjetër abuzimi me mjetin ligjor të parashikuar nga neni 479 i Kodit të Procedurës Civile mund të shkaktojë dhe aktivizimin e përgjegjësive personale pasurore të palës apo përfaqësuesit, sipas pikës 1 të nenit 34 të Kodit.

13- Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në funksion të zgjidhjes së çështjes konkrete, vlerëson se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë e

paraqitur nga pala e paditur, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, është e pabazuar në ligj dhe si e tillë nuk duhet të pranohet.

14- Ky Kolegj vëren se, në zbatim të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, bashkëlidhur kërkesës për pezullim të palës kërkuese Gentian Subashi, gjendet edhe kopja e rekursit të ushtruar nga kjo palë kundër vendimit gjyqësor që kërkohet të pezullohet ekzekutimit.

15- Gjithashtu, ky Kolegj vëren se palët e tjera pjesëmarrëse në gjykimin e çështjes ku është dhënë vendimi gjyqësor që kërkohet të pezullohet, janë njoftuar rregullisht për kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese Ministria e Financave dhe Ekonomisë, të cilat nuk kanë parashtruar argumente lidhur me bazueshmërinë në ligj të kërkesës për pezullim dhe për qëndrimin e tyre.

16- Nga shqyrtimi i shkaqeve konkrete për të cilat pala kërkuese Ministria e Financave dhe Ekonomisë kërkon pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, Kolegji Administrativ vlerëson se, kjo Kërkesë, në tërësinë e saj, motivohet me shkaqe që kanë të bëjnë vetëm me drejtësinë, bazueshmërinë në prova dhe në ligj, të vendimeve të dhëna nga gjykata administrative e shkallës së parë dhe ajo e Apelit në zgjidhjen e çështjes, të cilat ky Kolegj i vlerëson në kohën kur shqyrton në dhomë këshillimi shkaqet e rekursit ndaj vendimit të gjykatës administrative të apelit.

17- Për sa i përket motivit të fundit dhe të vetëm, që formalisht përfshihet në rastin e shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, Kolegji Administrativ vëren se pala kërkuese Ministria e Financave dhe Ekonomisë nuk ka paraqitur asnjë provë dhe nuk ka arsyetuar lidhur me ndonjë rrethanë konkrete për ta vlerësuar nëse jemi ose jo përpara rastit kur Gjykata e Lartë mund të konkludojë se nga ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit gjyqësor do të vinin pasoja të rënda financiare për palën kërkuese Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

18- Kolegji Administrativ vlerëson të evidentojë se, duke mbajtur parasysh edhe natyrën e mosmarrëveshjes mes palëve, pozitën e palës kreditore dhe asaj debitore, si edhe natyrën dhe vlerën e detyrimeve që kërkohet të ekzekutohen në çështjen konkrete në shqyrtim, në interpretim dhe zbatim të drejtë të ligjit procedural, mbetet thjesht një kërkim dhe pretendim hipotetik dhe, si i tillë, i pambështetur në ligj, vetëm parashtrimi formal i pretendimit (shkakut) se ekzekutimi mund të sjellë pasoja të rënda financiare, si një shkak që e përcakton vetë neni 479 pika 1 shkronja “a” e Kodit të Procedurës Civile, pa parashtruar njëkohësisht edhe argumenta dhe shpjegime konkrete lidhur me rrethanat që tregojnë mundësinë e ardhjes së tyre.

19- Për sa më sipër, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se nuk ka vend për të pranuar kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese Ministria e Financave dhe Ekonomisë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.2424, datë 17.09.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë dhe vendimit nr.2603, datë 12.06.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në bazë të nenit 1 pika 2 e ligjit nr.49/2012 “Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative” dhe nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile

V E N D O S I

Mospranimin e kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.2424, datë 17.09.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë dhe vendimit nr.2603, datë 12.06.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të paraqitur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Tiranë, më datë 18.05.2020

**ANËTAR
ERVIN PUPE**

**ANËTAR
ILIR PANDA**

**KRYESUES
SOKOL SADUSHI**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

Nr. 186 i Vendimit

V E N D I M

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

**Sokol Sadushi
Ervin Pupe
Ilir Panda**

**Kryesues
Anëtar
Anëtar**

Në datën 18.05.2020, mori në shqyrtim në dhomën e këshillimit çështjen administrative, që u përket palëve:

KËRKUES: Bashkia Tiranë

OBJEKTI: Pezullimi i ekzekutimit të vendimit nr.1957, datë 25.04.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr.2990, datë 12.11.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

BAZA LIGJORE: Neni 449, 479/a të Kodit të Procedurës Civile

Në çështjen me palë:

PADITËS: Besnik Balla

PADITUR: Bashkia Tiranë

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoji relacionin e gjyqtarit Sokol Sadushi dhe diskutoi çështjen në tërësi në dhomën e këshillimit,

VËREN

I- RRETHANAT E ÇËSHTJES

1- Nga aktet e administruara në praktikën gjyqësore, rezulton se pala paditëse Besnik Balla, ka punuar pranë palës së paditur Bashkia Tiranë, në pozicionin e Drejtor i Drejtorisë së Tatim-Taksave, pranë Njësisë Administrative Farkë.

2- Nga ana e palës së paditur Bashkia Tiranë, ka ristrukturuar organikën e saj dhe si pasojë, ka rezultuar se pozicioni i punës së palës paditëse është suprimuar dhe në kushtet e pamundësisë për ta sistemuar në një pozicion tjetër, është nxjerrë në lirim me vendimin nr.3223/3 prot., datë 01.02.2016 të Drejtorit të Drejtorisë së Planifikimit të Burimeve Njerëzore, Rekrutimit dhe Procedurave dhe urdhërit nr.4447 datë 10.02.2016 të Kryetarit të Bashkisë Tiranë.

3- Për sa më sipër, paditësi duke pretenduar se pala e paditur ka vepruar në kundërshtim me ligjin, i është drejtuar gjykatës me padinë objekt gjykimi.

4- Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr.1957, datë 25.04.2016 ka vendosur:

Pranimin e pjesshëm të padisë.

Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të akteve administrative, vendimit nr.3223/3 prot., datë 01.02.2016 të Drejtorit të Drejtorisë së Planifikimit të Burimeve Njerëzore, Rekrutimit dhe Procedurave dhe urdhërit nr.4447 datë 10.02.2016 të Kryetarit të Bashkisë Tiranë.

Detyrimin e palës së paditur që të kthejë paditësin në vendin e mëparshëm të punës, si Drejtor i Drejtorisë së Tatim Taksave, pranë Njësisë Administrative Farkë apo në një pozicion të barazvlefshëm me të.

Detyrimin e palës së paditur që të paguajë pagën nga data 10.02.2016 deri në rikthimin e paditësit në punë.

Rrëzimin e padisë për kërkimet e tjera të saj.

5- Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, me vendimin nr.2990, datë 12.11.2019 ka vendosur:

Lënien në fuqi të vendimit nr.1957, datë 25.04.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

6- Me datë **12.02.2020** Bashkia Tiranë, ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në thelb parashtron sa vijon:

- *Është i pabazuar arsyetimi i gjykatave, lidhur me pavlefshmërinë absolute të vendimit nr.3223/3 datë 01.02.2016 dhe urdhërit nr.4447 datë 10.02.2016, pasi nuk ka asnjë element të pavlefshmërisë absolute sipa nenit 116 të K.Pr.Administrative.*
- *Për shkak të krijimit të strukturës së re, Bashkia Tiranë ka qenë përpara kërkesave të nenit 50 pika 3 të ligjit 152/2013.*
- *Komisioni i Ristrukturimit në zbatim të nenit 50 dhe 66 të ligjit nr.152/2013, ka shqyrtuar mundësin e sistemimit të paditësit pozicioni i të cilit është shkurtuar, por si pasojë e pamundësisë për sistemimi është vendosur lirimi nga shërbimi civil.*
- *Ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda ekonomike.*

II- VLERËSIMI I KOLEGJIT ADMINISTRATIV TË GJYKATËS SË LARTË

7- Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve

mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

8- Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

9- Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:

a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme; dhe/ose

b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.

10- Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Koncretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- *ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të pariparueshëm dhe të atçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;*
- *(nuk) cenohet rëndë interesi publik.*

11- Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të inicuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

12- Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një

dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentat e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim.

13- Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore pasjell mospranimin e kërkesës për pezullim. Nga ana tjetër abuzimi me mjetin ligjor të parashkuar nga neni 479 i Kodit të Procedurës Civile mund të shkaktojë dhe aktivizimin e përgjegjësisë personale pasurore të palës apo përfaqësuesit, sipas pikës 1 të nenit 34 të Kodit.

14- Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në funksion të zgjidhjes së çështjes konkrete, vlerëson se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë e paraqitur nga pala e paditur, Bashkia Tiranë, është e pabazuar në ligj dhe si e tillë nuk duhet të pranohet.

15- Ky Kolegj vëren se, në zbatim të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, bashkëlidhur kërkesës për pezullim të palës kërkuese Bashkia Tiranë, gjendet edhe kopja e rekursit të ushtruar nga kjo palë kundër vendimit gjyqësor që kërkohet të pezullohet ekzekutimit.

16- Gjithashtu, ky Kolegj vëren se palët e tjera pjesëmarrëse në gjykimin e çështjes ku është dhënë vendimi gjyqësor që kërkohet të pezullohet, janë njoftuar rregullisht për kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese Bashkia Tiranë, të cilat nuk kanë parashtruar argumente lidhur me bazueshmërinë në ligj të kërkesës për pezullim dhe për qëndrimin e tyre.

17- Nga shqyrtimi i shkaqeve konkrete për të cilat pala kërkuese Bashkia Tiranë kërkon pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, Kolegji Administrativ vlerëson se, kjo Kërkesë, në tërësinë e saj, motivohet me shkaqe që kanë të bëjnë vetëm me drejtësinë, bazueshmërinë në prova dhe në ligj, të vendimeve të dhëna nga gjykata administrative e shkallës së parë dhe ajo e Apelit në zgjidhjen e çështjes, të cilat ky Kolegj i vlerëson në kohën kur shqyrton në dhomë këshillimi shkaqet e rekursit ndaj vendimit të gjykatës administrative të apelit.

18- Për sa i përket motivit të fundit dhe të vetëm, që formalisht përfshihet në rastin e shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, Kolegji Administrativ vëren se pala kërkuese Bashkia Tiranë nuk ka paraqitur asnjë provë dhe nuk ka arsyetuar lidhur me ndonjë rrethanë konkrete për ta vlerësuar nëse jemi ose jo përpara rastit kur Gjykata e Lartë mund të konkludojë se nga ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit gjyqësor do të vinin pasoja të rënda financiare për palën kërkuese Bashkia Tiranë.

19- Kolegji Administrativ vlerëson të evidentojë se, duke mbajtur parasysh edhe natyrën e mosmarrëveshjes mes palëve, pozitën e palës kreditore dhe asaj debitore, si edhe natyrën dhe vlerën e detyrimeve që kërkohet të ekzekutohen në çështjen konkrete në shqyrtim, në interpretim dhe zbatim të drejtë të ligjit procedural, mbetet thjesht një kërkim dhe pretendim hipotetik dhe, si i tillë, i pambështetur në ligj, vetëm parashtrimi formal i pretendimit (shkakut) se ekzekutimi mund të sjellë pasoja të rënda financiare, si një shkak që

e përcakton vetë neni 479 pika 1 shkronja “a” e Kodit të Procedurës Civile, pa parashtruar njëkohësisht edhe argumenta dhe shpjegime konkrete lidhur me rrethanat që tregojnë mundësinë e ardhjes së tyre.

20- Për sa më sipër, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se nuk ka vend për të pranuar kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese Bashkia Tiranë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.1957, datë 25.04.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr.2990, datë 12.11.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në bazë të nenit 1 pika 2 e ligjit nr.49/2012 “Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative” dhe nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile

V E N D O S I

Mospranimin e kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.1957, datë 25.04.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr.2990, datë 12.11.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, të paraqitur nga Bashkia Tiranë.

Tiranë, më datë 18.05.2020

ANËTAR
ERVIN PUPE

ANËTAR
ILIR PANDA

KRYESUES
SOKOL SADUSHI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

Nr. 190 i Vendimit

V E N D I M

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

**Sokol Sadushi
Ervin Pupe
Ilir Panda**

**Kryesues
Anëtar
Anëtar**

Në datën 18.05.2020, mori në shqyrtim në dhomën e këshillimit çështjen administrative, që u përket palëve:

KËRKUES: Klodian Kuqali

OBJEKTI: Pezullimi i ekzekutimit të vendimit nr.2439 (86-2019-2793), datë 18.09.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

BAZA LIGJORE: Neni 479 të Kodit të Procedurës Civile

Në çështjen me palë:

PADITËS: Klodian Kuqali

PADITUR: Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve dega Korçë

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoji relacionin e gjyqtarit Sokol Sadushi dhe diskutoi çështjen në tërësi në dhomën e këshillimit,

VËREN

I- RRETHANAT E ÇËSHTJES

1- Nga aktet e administruara në praktikën gjyqësore, rezulton se pala paditëse Klodian Kuqali, është banor i fshatit Vithkuq në qytetin e Korçës dhe duke qenë zonë malore, pretendon se për shkak të dimrit kishte siguruar një sasi lënde drusore.

2- Nga ana e palës së paditur Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve dega Korçë, është ushtruar kontroll në aksin rrugor Korçë – Ersek dhe nga verifikimi kanë ndaluar paditësinë me një sasi drusore padokumentacionin përkatëse dhe në këto kushte kanë vendosur dënimin me gjobë në masën 5.000.000 lekë.

3- Për sa më sipër, paditësi duke pretenduar se pala e paditur ka vepruar në kundërshtim me ligjin, i është drejtuar gjykatës me padinë objekt gjykimi.

4- **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë**, me vendimin nr.1210 (487), datë 21.10.2016 ka vendosur:

Pranimin e padisë së paditësit Klodian Kuqali, palë e paditur ISHMPU Dega Korçë, me objekt “konstatimin e paligjshmërisë së aktit administrativ, vendim “për dënimin administrativ” nr.63 datë 05.06.2016, me nr.serie 0004918 të ISHMP Dega Korçë” duke e shfuqizuar vendimin nr.65 datë 05.06.2016 i Inspektoriatit Shtetëror të Mjedisit Pyjeve Dega Korçë si akt në kundërshtim me ligjin.

5- **Gjykata Administrative e Apelit Tiranë**, me vendimin nr.2439 (86-2019-2793), datë 18.09.2019 ka vendosur:

Ndryshimin e vendimit nr.1210 (487), datë 21.10.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë.

Rrëzimin e padisë.

6- Më datë **18.02.2020** Klodian Kuqali, ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në thelb parashtron sa vijon:

- *Vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit është frutë i një zbatimi të keq të ligjit procedural.*
- *Ankuesi sqaron se lënda drusore e cila është gjetur nga pala e paditur e ka blerë rreth 7 muaj dhe e dispononte në shtëpinë e vetë dhe nuk e kishte për tregti, por për t'ia cuar motrës e cila banon disa minuta larg fshatit Vithkuq .*
- *ISHMP –ja mori një vendim komplet të gabuar dhe të nxituar, pasi nuk hetoi aspak rastin në fjalë dhe pa kaluar as 12 orë morën vendimin me një gjobë prej 5.00.000 lekë të reja dhe Gjykata Administrative e Shkallës së Parë me të drejtë pranoi padinë pasi nuk u provua shkelja sipas nenit 2 të ligjit nr.5/2016 “Për moratoriumin në pyje”.*
- *Ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda dhe të pariparueshme për të gjithë jetën.*

II- VLERËSIMI I KOLEGJIT ADMINISTRATIV TË GJYKATËS SË LARTË

7- Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm,

sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

8- Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atçastshëm dhe eminent për shkakimin e një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

9- Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:

a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme; dhe/ose

b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.

10- Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- *ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të pariparueshëm dhe të atçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;*
- *(nuk) cenohet rëndë interesi publik.*

11- Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të inicuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

12- Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentat e parashtruara të palës kërkuese

duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim.

13- Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim. Nga ana tjetër abuzimi me mjetin ligjor të parashikuar nga neni 479 i Kodit të Procedurës Civile mund të shkaktojë dhe aktivizimin e përgjegjësive personale pasurore të palës apo përfaqësuesit, sipas pikës 1 të nenit 34 të Kodit.

14- Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në funksion të zgjidhjes së çështjes konkrete, vlerëson se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë e paraqitur nga pala e paditur, Klodian Kuqali, është e pabazuar në ligj dhe si e tillë nuk duhet të pranohet.

15- Ky Kolegj vëren se, në zbatim të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, bashkëlidhur kërkesës për pezullim të palës kërkuese Klodian Kuqali, gjendet edhe kopja e rekursit të ushtruar nga kjo palë kundër vendimit gjyqësor që kërkohet të pezullohet ekzekutimit.

16- Gjithashtu, ky Kolegj vëren se palët e tjera pjesëmarrëse në gjykimin e çështjes ku është dhënë vendimi gjyqësor që kërkohet të pezullohet, janë njoftuar rregullisht për kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese Klodian Kuqali, të cilat nuk kanë parashtruar argumente lidhur me bazueshmërinë në ligj të kërkesës për pezullim dhe për qëndrimin e tyre.

17- Nga shqyrtimi i shkaqeve konkrete për të cilat pala kërkuese Klodian Kuqali kërkon pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, Kolegji Administrativ vlerëson se, kjo Kërkesë, në tërësinë e saj, motivohet me shkaqe që kanë të bëjnë vetëm me drejtësinë, bazueshmërinë në prova dhe në ligj, të vendimeve të dhëna nga gjykata administrative e shkallës së parë dhe ajo e Apelit në zgjidhjen e çështjes, të cilat ky Kolegj i vlerëson në kohën kur shqyrton në dhomë këshillimi shkaqet e rekursit ndaj vendimit të gjykatës administrative të apelit.

18- Për sa i përket motivit të fundit dhe të vetëm, që formalisht përfshihet në rastin e shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, Kolegji Administrativ vëren se pala kërkuese Klodian Kuqali nuk ka paraqitur asnjë provë dhe nuk ka arsyetuar lidhur me ndonjë rrethanë konkrete për ta vlerësuar nëse jemi ose jo përpara rastit kur Gjykata e Lartë mund të konkludojë se nga ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit gjyqësor do të vinin pasoja të rënda financiare për palën kërkuese Klodian Kuqali.

19- Kolegji Administrativ vlerëson të evidentojë se, duke mbajtur parasysh edhe natyrën e mosmarrëveshjes mes palëve, pozitën e palës kreditore dhe asaj debitore, si edhe natyrën dhe vlerën e detyrimeve që kërkohet të ekzekutohen në çështjen konkrete në shqyrtim, në interpretim dhe zbatim të drejtë të ligjit procedural, mbetet thjesht një kërkim dhe pretendim hipotetik dhe, si i tillë, i pambështetur në ligj, vetëm parashtrimi formal i pretendimit (shkakut) se ekzekutimi mund të sjellë pasoja të rënda financiare, si një shkak që e përcakton vetë neni 479 pika 1 shkronja “a” e Kodit të Procedurës Civile, pa parashtruar njëkohësisht edhe argumenta dhe shpjegime konkrete lidhur me rrethanat që tregojnë mundësinë e ardhjes së tyre.

20- Ky Kolegj, vlerëson të theksojë qëndrimin e Gjykatës së Lartë, e cila çon automatikisht në rrëzimin e kërkesës si të pambështetur në ligj, se kërkesa për pezullimin e ekzekutimit, vendoset kur kemi të bëjmë me vendime gjyqësore që mbartin detyrime për palët dhe në rastin konkret jemi para rastit kur kërkesa është rrëzuar nga ana e gjykatës dhe nuk ka ngarkuar me detyrime asnjë nga palët ndërgjyqëse. Gjithashtu nga ana e palës paditëse nuk është vendosur garanci në zbatim të nenit 479 pika 1 gërma “b” të K.Pr.Civile.

21- Për sa më sipër, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se nuk ka vend për të pranuar kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese Klodian Kuqali, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.2439 (86-2019-2793), datë 18.09.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në bazë të nenit 1 pika 2 e ligjit nr.49/2012 “Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative” dhe nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile

V E N D O S I

Mospranimin e kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.2439 (86-2019-2793), datë 18.09.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, të paraqitur nga Klodian Kuqali.

Tiranë, më datë 18.05.2020

**ANËTAR
ERVIN PUPE**

**ANËTAR
ILIR PANDA**

**KRYESUES
SOKOL SADUSHI**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

Nr.200 i Vendimit

V E N D I M

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

**Sokol Sadushi
Ervin Pupe
Ilir Panda**

**Kryesues
Anëtar
Anëtar**

Në datën 18.05.2020, mori në shqyrtim në dhomën e këshillimit çështjen administrative, që u përket palëve:

KËRKUES: Agjencia Shtetërore e Kadastrës

OBJEKTI: Pezullimi i ekzekutimit të vendimit nr.2023, datë 27.06.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

BAZA LIGJORE: Neni 479/a të Kodit të Procedurës Civile

Në çështjen me palë:

PADITËS: Teodor Sila

PADITUR: Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ish ZQRPP Tiranë)

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoji relacionin e gjyqtarit Sokol Sadushi dhe diskutoi çështjen në tërësi në dhomën e këshillimit,

VËREN

I- RRETHANAT E ÇËSHTJES

1- Nga aktet e administruara në praktikën gjyqësore, rezulton se pala paditëse Teodor Sila, ka punuar pranë palës së paditur Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ish ZQRPP Tiranë), në pozicionin e “specialistit në sektorin e regjistrimit fillestar”.

2- Nga ana e palës së paditur Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ish ZQRPP Tiranë), është ristrukturuar organikën e saj dhe si pasojë, ka rezultuar se pozicioni i punës së palës paditëse është suprimuar dhe në këto kushtet është bërë ndërprerja e marrëdhënies së punës.

3- Për sa më sipër, paditësi duke pretenduar se pala e paditur ka vepruar në kundërshtim me ligjin, i është drejtuar gjykatës me padinë objekt gjykimi.

4- Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës, me vendimin nr.641, datë 01.07.2016 ka vendosur:

Pranimin e pjesshëm të padisë.

Detyrimin e palës së paditur Zyra Qëndrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, të dëmshpërblejë paditësin Teodor Sila me 7 (shtatë) muaj pagë për shkak të zgjidhjes së kontratës së punës në mënyrë të menjëhershme pa shkaqe të arsyeshme.

Detyrimin e palës së paditur Zyra Qëndrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, të dëmshpërblejë paditësin Teodor Sila me 2 (dy) muaj pagë për mosrespektim të aftit të njoftimit.

Detyrimin e palës së paditur Zyra Qëndrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, të dëmshpërblejë paditësin Teodor Sila me 2 (dy) muaj pagë për mosrespektim të procedurës.

Detyrimin e palës së paditur të paguajë 1 (një) pagë mujore për pushimet vjetore të pamarra.

Rrëzimin e padisë në kërkimet e tjera.

5- Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, me vendimin nr.2023, datë 27.06.2019 ka vendosur:

Lënien në fuqi të vendimit nr.641, datë 01.07.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës.

6- Më datë **25.07.2019** Agjencia Shtetërore e Kadastrës, ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në thelb parashtrohet sa vijon:

- *Agjencia Shtetërore e Kadastrës ka ushtruar të drejtën e recursit në përputhje me afatin ligjor të parashikuar në K.Pr.Civile ndaj të dy vendimeve dhe ka kërkuar rrëzimin e padisë.*
- *Nisur nga fakti se çështja është duke u shqyrtuar në Gjykatën e Lartë dhe ekzekutimit i vendimit do të sillte pasoja të rënda financiare për institucionin tonë.*

II- VLERËSIMI I KOLEGJIT ADMINISTRATIV TË GJYKATËS SË LARTË

7- Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto

mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

8- Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të riparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

9- Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:

a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të riparueshme; dhe/ose

b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.

10- Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- *ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të riparueshëm dhe të atçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;*
- *(nuk) cenohet rëndë interesi publik.*

11- Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të inicuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

12- Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentat e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes

së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim.

13- Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim. Nga ana tjetër abuzimi me mjetin ligjor të parashikuar nga neni 479 i Kodit të Procedurës Civile mund të shkaktojë dhe aktivizimin e përgjegjësisë personale pasurore të palës apo përfaqësuesit, sipas pikës 1 të nenit 34 të Kodit.

14- Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në funksion të zgjidhjes së çështjes konkrete, vlerëson se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë e paraqitur nga pala e paditur, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, është e pabazuar në ligj dhe si e tillë nuk duhet të pranohet.

15- Ky Kolegj vëren se, në zbatim të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, bashkëlidhur kërkesës për pezullim të palës kërkuese Agjencia Shtetërore e Kadastrës, gjendet edhe kopja e rekursit të ushtruar nga kjo palë kundër vendimit gjyqësor që kërkohet të pezullohet ekzekutimit.

16- Gjithashtu, ky Kolegj vëren se palët e tjera pjesëmarrëse në gjykimin e çështjes ku është dhënë vendimi gjyqësor që kërkohet të pezullohet, janë njoftuar rregullisht për kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese Agjencia Shtetërore e Kadastrës, të cilat nuk kanë parashtruar argumente lidhur me bazueshmërinë në ligj të kërkesës për pezullim dhe për qëndrimin e tyre.

17- Nga shqyrtimi i shkaqeve konkrete për të cilat pala kërkuese Agjencia Shtetërore e Kadastrës kërkon pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, Kolegji Administrativ vlerëson se, kjo Kërkesë, në tërësinë e saj, motivohet me shkaqe që kanë të bëjnë vetëm me drejtësinë, bazueshmërinë në prova dhe në ligj, të vendimeve të dhëna nga gjykata administrative e shkallës së parë dhe ajo e Apelit në zgjidhjen e çështjes, të cilat ky Kolegj i vlerëson në kohën kur shqyrton në dhomë këshillimi shkaqet e rekursit ndaj vendimit të gjykatës administrative të apelit.

18- Për sa i përket motivit të fundit dhe të vetëm, që formalisht përfshihet në rastin e shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, Kolegji Administrativ vëren se pala kërkuese Agjencia Shtetërore e Kadastrës nuk ka paraqitur asnjë provë dhe nuk ka arsyetuar lidhur me ndonjë rrethanë konkrete për ta vlerësuar nëse jemi ose jo përpara rastit kur Gjykata e Lartë mund të konkludojë se nga ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit gjyqësor do të vinin pasoja të rënda financiare për palën kërkuese Agjencia Shtetërore e Kadastrës.

19- Kolegji Administrativ vlerëson të evidentojë se, duke mbajtur parasysh edhe natyrën e mosmarrëveshjes mes palëve, pozitën e palës kreditore dhe asaj debitore, si edhe natyrën dhe vlerën e detyrimeve që kërkohet të ekzekutohen në çështjen konkrete në shqyrtim, në interpretim dhe zbatim të drejtë të ligjit procedural, mbetet thjesht një kërkim dhe pretendim hipotetik dhe, si i tillë, i pambështetur në ligj, vetëm parashtrimi formal i pretendimit (shkakut) se ekzekutimi mund të sjellë pasoja të rënda financiare, si një shkak që e përcakton vetë neni 479 pika 1 shkronja “a” e Kodit të Procedurës Civile, pa parashtruar njëkohësisht edhe argumenta dhe shpjegime konkrete lidhur me rrethanat që tregojnë mundësinë e ardhjes së tyre.

20- Për sa më sipër, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se nuk ka vend për të pranuar kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese Agjencia Shtetërore e Kadastrës, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.2023, datë 27.06.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në bazë të nenit 1 pika 2 e ligjit nr.49/2012 “Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative” dhe nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile

V E N D O S I

Mospranimin e kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.2023, datë 27.06.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, të paraqitur nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës.

Tiranë, më datë 18.05.2020

**ANËTAR
ERVIN PUPE**

**ANËTAR
ILIR PANDA**

**KRYESUES
SOKOL SADUSHI**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

Nr. 138/495 i Vendimit

V E N D I M

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

**Sokol Sadushi
Ervin Pupe
Ilir Panda**

**Kryesues
Anëtar
Anëtar**

Në datën 18.05.2020, mori në shqyrtim në dhomën e këshillimit çështjen administrative, që u përket palëve:

KËRKUES: Drejtoria e Përgjithshme Nr.1 e Punëtorëve të Qytetit

OBJEKTI: Pezullimi i ekzekutimit të vendimit nr.2302, datë 23.07.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë dhe vendimit nr.2775, datë 02.06.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

BAZA LIGJORE: Neni 479 të Kodit të Procedurës Civile

Në çështjen me Palë:

PADITËS: Sanie Murati

PADITUR: Drejtoria e Përgjithshme Nr.1 e Punëtorëve të Qytetit

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoji relacionin e gjyqtarit Sokol Sadushi dhe diskutoi çështjen në tërësi në dhomën e këshillimit,

VËREN

I- RRETHANAT E ÇËSHTJES

1- Nga aktet e administruara në praktikën gjyqësore, rezulton se pala paditëse Sanie Murati, ka punuar pranë palës së paditur Drejtoria e Përgjithshme Nr.1 e Punëtorëve të Qytetit, në pozicionin e “punëtor pastrimi”.

2- Nga ana e palës së paditur Drejtoria e Përgjithshme Nr.1 e Punëtorëve të Qytetit, është ristrukturuar organikën e saj dhe si pasojë, ka rezultuar se pozicioni i punës së palës paditëse është suprimuar dhe në këto kushtet është ndërprerë marrëdhënia e punës.

3- Për sa më sipër, paditësi duke pretenduar se pala e paditur ka vepruar në kundërshtim me ligjin, i është drejtuar gjykatës me padinë objekt gjykimi.

4- **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë**, me vendimin nr.2775, datë 02.06.2016 ka vendosur:

Pranimin pjesërisht të kërkesë padisë.

Detyrimin e palës së paditur Drejtoria e Përgjithshme Nr.1 e Punëtorëve të Qytetit, pranë Bashkia Tiranë, ti paguajë paditëses Sanie Murati një dëmshpërblim prej 12 (dymbëdhjetë) muaj pagë, për shkak të zgjidhje së menjëhershme të pajustificuar të kontratës së punës.

Detyrimin e palës së paditur Drejtoria e Përgjithshme Nr.1 e Punëtorëve të Qytetit, pranë Bashkia Tiranë, ti paguajë paditësit një dëmshpërblim prej 3 (tre) muaj pagë, për shkak të mosrespektimit të afatit të njoftimit në zgjidhjen e kontratës së punës.

Detyrimin e palës së paditur Drejtoria e Përgjithshme Nr.1 e Punëtorëve të Qytetit, pranë Bashkia Tiranë, ti paguajë paditësit shpërblim për vjetërsi në punë prej 7 (shtatë) muaj pagë.

Rrëzimin e kërkesë padisë për pjesën tjetër, si të pabazuar në ligj dhe në prova.

5- **Gjykata Administrative e Apelit Tiranë**, me vendimin nr.2302, datë 23.07.2019 ka vendosur:

Lënien në fuqi të vendimit nr.2775, datë 02.06.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

6- Më datë **15.11.2019** Drejtoria e Përgjithshme Nr.1 e Punëtorëve të Qytetit, ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në thelb parashtron sa vijon:

- *Vendimi i dhënë nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë është marrë në zbatim të gabuar të ligjit dhe në shkelje të normave procedurale.*
- *Pala e paditur ka provuar përpara gjykatës respektimin e afatit të njoftimit për zgjidhjen e kontratës së punës sipas nenit 143 të Kodit të Punës, pasi paditës është njoftuar për zgjidhje e kontratës në zbatim të vendimit të Këshillit Bashkiak nr.41 datë 23.09.2015 “Për riorganizimin e Drejtoria e Përgjithshme Nr.1 e Punëtorëve të Qytetit...” ku nga 560 punëtor do të bëhen 360.*
- *Gjykata ka vendosur gabim kur ka dëmshpërblyer paditësin, pasi pushimi ka qenë për shkaqe të justifikuar dhe në mënyrë të menjëhershme, sepse punëdhënësi ka qenë i detyruar për të zbatuar organikën e re, në zbatim edhe të vendimit unifikues të Gjykatës së Lartë nr.19 datë 15.11.2017.*
- *Ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda dhe të pariparueshme.*

II- VLERËSIMI I KOLEGJIT ADMINISTRATIV TË GJYKATËS SË LARTË

7- Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

8- Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

9- Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:

a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme; dhe/ose

b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.

10- Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- *ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të pariparueshëm dhe të atçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;*
- *(nuk) cenohet rëndë interesi publik.*

11- Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të inicuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

12- Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të

formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentat e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim.

13- Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim. Nga ana tjetër abuzimi me mjetin ligjor të parashkuar nga neni 479 i Kodit të Procedurës Civile mund të shkaktojë dhe aktivizimin e përgjegjësisë personale pasurore të palës apo përfaqësuesit, sipas pikës 1 të nenit 34 të Kodit.

14- Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në funksion të zgjidhjes së çështjes konkrete, vlerëson se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë e paraqitur nga pala e paditur, Drejtoria e Përgjithshme Nr.1 e Punëtorëve të Qytetit, është e pabazuar në ligj dhe si e tillë nuk duhet të pranohet.

15- Ky Kolegj vëren se, në zbatim të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, bashkëlidhur kërkesës për pezullim të palës kërkuese Drejtoria e Përgjithshme Nr.1 e Punëtorëve të Qytetit, gjendet edhe kopja e rekursit të ushtruar nga kjo palë kundër vendimit gjyqësor që kërkohet të pezullohet ekzekutimit.

16- Gjithashtu, ky Kolegj vëren se palët e tjera pjesëmarrëse në gjykimin e çështjes ku është dhënë vendimi gjyqësor që kërkohet të pezullohet, janë njoftuar rregullisht për kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese Drejtoria e Përgjithshme Nr.1 e Punëtorëve të Qytetit, të cilat nuk kanë parashtruar argumente lidhur me bazueshmërinë në ligj të kërkesës për pezullim dhe për qëndrimin e tyre.

17- Nga shqyrtimi i shkaqeve konkrete për të cilat pala kërkuese Drejtoria e Përgjithshme Nr.1 e Punëtorëve të Qytetit kërkon pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, Kolegji Administrativ vlerëson se, kjo Kërkesë, në tërësinë e saj, motivohet me shkaqe që kanë të bëjnë vetëm me drejtësinë, bazueshmërinë në prova dhe në ligj, të vendimeve të dhëna nga gjykata administrative e shkallës së parë dhe ajo e Apelit në zgjidhjen e çështjes, të cilat ky Kolegj i vlerëson në kohën kur shqyrton në dhomë këshillimi shkaqet e rekursit ndaj vendimit të gjykatës administrative të apelit.

18- Për sa i përket motivit të fundit dhe të vetëm, që formalisht përfshihet në rastin e shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, Kolegji Administrativ vëren se pala kërkuese Drejtoria e Përgjithshme Nr.1 e Punëtorëve të Qytetit nuk ka paraqitur asnjë provë dhe nuk ka arsytuar lidhur me ndonjë rrethanë konkrete për ta vlerësuar nëse jemi ose jo përpara rastit kur Gjykata e Lartë mund të konkludojë se nga ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit gjyqësor do të vinin pasoja të rënda financiare për palën kërkuese Drejtoria e Përgjithshme Nr.1 e Punëtorëve të Qytetit.

19- Kolegji Administrativ vlerëson të evidentojë se, duke mbajtur parasysh edhe natyrën e mosmarrëveshjes mes palëve, pozitën e palës kreditore dhe asaj debitore, si edhe

natyrën dhe vlerën e detyrimeve që kërkohet të ekzekutohen në çështjen konkrete në shqyrtim, në interpretim dhe zbatim të drejtë të ligjit procedural, mbetet thjesht një kërkim dhe pretendim hipotetik dhe, si i tillë, i pambështetur në ligj, vetëm parashtrimi formal i pretendimit (shkakut) se ekzekutimi mund të sjellë pasoja të rënda financiare, si një shkak që e përcakton vetë neni 479 pika 1 shkronja “a” e Kodit të Procedurës Civile, pa parashtruar njëkohësisht edhe argumenta dhe shpjegime konkrete lidhur me rrethanat që tregojnë mundësinë e ardhjes së tyre.

20- Për sa më sipër, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se nuk ka vend për të pranuar kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese Drejtoria e Përgjithshme Nr.1 e Punëtorëve të Qytetit, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.2302, datë 23.07.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë dhe vendimit nr.2775, datë 02.06.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në bazë të nenit 1 pika 2 e ligjit nr.49/2012 “Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative” dhe nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile

V E N D O S I

Mospranimin e kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.2302, datë 23.07.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë dhe vendimit nr.2775, datë 02.06.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme Nr.1 e Punëtorëve të Qytetit.

Tiranë, më datë 18.05.2020

**ANËTAR
ERVIN PUPE**

**ANËTAR
ILIR PANDA**

**KRYESUES
SOKOL SADUSHI**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

Nr. 140/497 i Vendimit

V E N D I M

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

**Sokol Sadushi
Ervin Pupe
Ilir Panda**

**Kryesues
Anëtar
Anëtar**

Në datën 18.05.2020, mori në shqyrtim në dhomën e këshillimit çështjen administrative, që u përket palëve:

KËRKUES: Drejtoria Vendore Vlorë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës

OBJEKTI: Pezullimi i ekzekutimit të vendimit nr.1943, datë 20.06.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

BAZA LIGJORE: Neni 479 të Kodit të Procedurës Civile

Në çështjen me palë:

PADITËS: Morande Hoxha

PADITUR: Drejtoria Vendore Vlorë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoji relacionin e gjyqtarit Sokol Sadushi dhe diskutoi çështjen në tërësi në dhomën e këshillimit,

VËREN

I- RRETHANAT E ÇËSHTJES

1- Nga aktet e administruara në praktikën gjyqësore, rezulton se pala paditëse Morande Hoxha, ka punuar pranë palës së paditur Drejtoria Vendore Vlorë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, në pozicionin e “Jurist”.

2- Nga ana e palës së paditur Drejtoria Vendore Vlorë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, është bërë ndërprerja e marrëdhënies së punës me palën paditëse, duke mos i rinovuar më kontratën e punës, me arsyetimin se është në kushtet e paaftësisë financiare.

3- Për sa më sipër, paditësi duke pretenduar se pala e paditur ka vepruar në kundërshtim me ligjin, i është drejtuar gjykatës me padinë objekt gjykimi.

4- **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë**, me vendimin nr.94, datë 04.02.2016 ka vendosur:

Pranimin e pjesshëm të kërkesë padisë.

Detyrimin e palës së paditur që t’i paguajë paditësit Morande Hoxha një dëmshpërblim prej 6 muaj pagë për shkak të zgjidhjes së menjëhershme e të pajustificuar të kontratës së punës.

Detyrimin e palës së paditur që t’i paguajë paditësit një shpërblim prej 1 muaj pagë për mosrespektim të afatit të njoftimit për zgjidhjen e kontratës së punës.

Detyrimin e palës së paditur që t’i paguajë paditësit një dëmshpërblim prej 2 muaj pagë për mosrespektim të procedurës për zgjidhjes e kontratës së punës.

Rrëzimin për pjesën tjetër të kërkesë padisë.

5- **Gjykata Administrative e Apelit Tiranë**, me vendimin nr.1943, datë 20.06.2019 ka vendosur:

Ndryshimin e vendimit nr.94, datë 04.02.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.

Pranimin pjesërisht të kërkesë padisë.

Detyrimin e palës së paditur t’i paguajë paditësit Morande Hoxha pagën për periudhën 10.10.2013-31.12.2013.

Rrëzimin e padisë për kërkimet e tjera.

6- Më datë **15.11.2019** Drejtoria Vendore Vlorë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në thelb parashtrohet sa vijon:

- *Paditësi ka qenë jurist pranë ish Drejtorisë së ALUIZNI-t Vlorë dhe pagesa për këtë punonjës është bërë sipas VKM nr.934, datë 26.12.2012, pra realizohej nga të ardhurat e vetë institucionit.*
 - *Për shkak të paaftësisë financiare të ALUIZNI-t, për përballimin e pagave të punonjësve me kontratë të përkohshme, ka dalë urdhëri nr.526 datë 10.10.2013 për mosrinovimin e kontratave individuale në vijim.*
 - *Zgjidhja e kontratës së punës për paditësin është bërë për arsye të paaftësisë financiare të institucionit për të paguar, gjë që përbën shkak të justifikuar për zgjidhje e kësaj kontrate.*
- Ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda ekonomike.*

II- VLERËSIMI I KOLEGJIT ADMINISTRATIV TË GJYKATËS SË LARTË

7- Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve

mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

8- Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

9- Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:

a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme; dhe/ose

b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.

10- Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Koncretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- *ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të pariparueshëm dhe të atçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;*
- *(nuk) cenohet rëndë interesi publik.*

11- Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të inicuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

12- Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një

dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentat e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim.

13- Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim. Nga ana tjetër abuzimi me mjetin ligjor të parashikuar nga neni 479 i Kodit të Procedurës Civile mund të shkaktojë dhe aktivizimin e përgjegjësisë personale pasurore të palës apo përfaqësuesit, sipas pikës 1 të nenit 34 të Kodit.

14- Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në funksion të zgjidhjes së çështjes konkrete, vlerëson se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë e paraqitur nga pala e paditur, Drejtoria Vendore Vlorë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, është e pabazuar në ligj dhe si e tillë nuk duhet të pranohet.

15- Ky Kolegj vëren se, në zbatim të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, bashkëlidhur kërkesës për pezullim të palës kërkuese Drejtoria Vendore Vlorë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, gjendet edhe kopja e rekursit të ushtruar nga kjo palë kundër vendimit gjyqësor që kërkohet të pezullohet ekzekutimit.

16- Gjithashtu, ky Kolegj vëren se palët e tjera pjesëmarrëse në gjykimin e çështjes ku është dhënë vendimi gjyqësor që kërkohet të pezullohet, janë njoftuar rregullisht për kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese Drejtoria Vendore Vlorë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, të cilat nuk kanë parashtruar argumente lidhur me bazueshmërinë në ligj të kërkesës për pezullim dhe për qëndrimin e tyre.

17- Nga shqyrtimi i shkaqeve konkrete për të cilat pala kërkuese Drejtoria Vendore Vlorë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës kërkon pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, Kolegji Administrativ vlerëson se, kjo Kërkesë, në tërësinë e saj, motivohet me shkaqe që kanë të bëjnë vetëm me drejtësinë, bazueshmërinë në prova dhe në ligj, të vendimeve të dhëna nga gjykata administrative e shkallës së parë dhe ajo e Apelit në zgjidhjen e çështjes, të cilat ky Kolegj i vlerëson në kohën kur shqyrton në dhomë këshillimi shkaqet e rekursit ndaj vendimit të gjykatës administrative të apelit.

18- Për sa i përket motivit të fundit dhe të vetëm, që formalisht përfshihet në rastin e shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, Kolegji Administrativ vëren se pala kërkuese Drejtoria Vendore Vlorë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës nuk ka paraqitur asnjë provë dhe nuk ka arsyetuar lidhur me ndonjë rrethanë konkrete për ta vlerësuar nëse jemi ose jo përpara rastit kur Gjykata e Lartë mund të konkludojë se nga ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit gjyqësor do të vinin pasoja të rënda financiare për palën kërkuese Drejtoria Vendore Vlorë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës.

19- Kolegji Administrativ vlerëson të evidentojë se, duke mbajtur parasysh edhe natyrën e mosmarrëveshjes mes palëve, pozitën e palës kreditore dhe asaj debitore, si edhe natyrën dhe vlerën e detyrimeve që kërkohet të ekzekutohen në çështjen konkrete në shqyrtim, në interpretim dhe zbatim të drejtë të ligjit procedural, mbetet thjesht një kërkim

dhe pretendim hipotetik dhe, si i tillë, i pambështetur në ligj, vetëm parashtrimi formal i pretendimit (shkakut) se ekzekutimi mund të sjellë pasoja të rënda financiare, si një shkak që e përcakton vetë neni 479 pika 1 shkronja “a” e Kodit të Procedurës Civile, pa parashtruar njëkohësisht edhe argumenta dhe shpjegime konkrete lidhur me rrethanat që tregojnë mundësinë e ardhjes së tyre.

20- Për sa më sipër, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se nuk ka vend për të pranuar kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese Drejtoria Vendore Vlorë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.1943, datë 20.06.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në bazë të nenit 1 pika 2 e ligjit nr.49/2012 “Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative” dhe nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile

V E N D O S I

Mospranimin e kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.1943, datë 20.06.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, të paraqitur nga Drejtoria Vendore Vlorë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës.

Tiranë, më datë 18.05.2020

**ANËTAR
ERVIN PUPE**

**ANËTAR
ILIR PANDA**

**KRYESUES
SOKOL SADUSHI**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

Nr. 148/509 i Vendimit

**V E N D I M
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

Sokol Sadushi	Kryesues
Ervin Pupe	Anëtar
Illir Panda	Anëtar

Në datën 18.05.2020 mori në shqyrtim në dhomën e këshillimit çështjen administrative, që u përket palëve:

KËRKUES: Shpëtim Gjona

OBJEKTI: Pezullimi i ekzekutimit të vendimit nr.(28) 8, datë 09.01.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë, lënë në fuqi me vendimin nr.1476, datë 14.05.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

BAZA LIGJORE: Neni 479 “a” të Kodit të Procedurës Civile

Në çështjen me palë:

PADITËS: Shpëtim Gjona

PADITUR: Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoji relacionin e gjyqtarit Sokol Sadushi dhe diskutoi çështjen në tërësi në dhomën e këshillimit,

VËREN

I- RRETHANAT E ÇËSHTJES

1- Nga aktet e administruara në praktikën gjyqësore, rezulton se pala paditëse Shpëtim Gjona, në vitin 2009 ka ndërtuar pa leje një objekt një katësh, në fshatinë Veliternë,

Njësia Administrative Pirg, Bashkia Maliq dhe në 2016 ka paraqitur kërkesë për legalizim pranë ALUIZNI-t.

2- Nga ana e palës së paditur Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, është ushtruar kontroll pranë palës së paditur dhe kanë konstatuar se në objektin e sipërcituar është ndërtuar edhe një kat tjetër pa leje të organeve kompetente, për këtë shkak është nxjerrë vendimin nr.24 datë 11.11.2016 është vendosur prishja e objektit dhe vendimi nr.28 datë 11.11.2016 për dënimin me 500.000 lekë gjobë.

3- Për sa më sipër, paditësi duke pretenduar se pala e paditur ka vepruar në kundërshtim me ligjin, i është drejtuar gjykatës me padinë objekt gjykimi.

4- **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë**, me vendimin nr.(28) 8, datë 09.01.2017 ka vendosur:
Rrëzimin e padisë si të pabazuar në prova dhe në ligj.

5- **Gjykata Administrative e Apelit Tiranë**, me vendimin nr.1476, datë 14.05.2019 ka vendosur:
Lënien në fuqi të vendimit nr.(28) 8, datë 09.01.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë.

6- Më datë **03.12.2019** Shpëtim Gjona, ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në thelb parashtron sa vijon:

- *Duke qenë se ky vendim tashmë është i formës së prerë dhe lehtësisht do të paraqitet për ekzekutim dhe duke vlerësuar se ekzekutimi i menjëhershëm do të prish menjëherë objektin e ndërtuar nga pala paditëse, nuk do të kishte asnjë kuptim vazhdimi i gjykimit.*

II- VLERËSIMI I KOLEGJIT ADMINISTRATIV TË GJYKATËS SË LARTË

7- Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

8- Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

9- Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:

a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme; dhe/ose

b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.

10- Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- *ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të pariparueshëm dhe të atëçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;*
- *(nuk) cenohet rëndë interesi publik.*

11- Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të inicuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

12- Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentat e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim.

13- Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim. Nga ana tjetër abuzimi me mjetin ligjor të parashikuar nga neni 479 i Kodit të Procedurës Civile mund të shkaktojë dhe aktivizimin e përgjegjësive personale pasurore të palës apo përfaqësuesit, sipas pikës 1 të nenit 34 të Kodit.

14- Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në funksion të zgjidhjes së çështjes konkrete, vlerëson se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë e

paraqitur nga pala e paditur, Shpëtim Gjona, është e pabazuar në ligj dhe si e tillë nuk duhet të pranohet.

15- Ky Kolegj vëren se, në zbatim të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, bashkëlidhur kërkesës për pezullim të palës kërkuese Shpëtim Gjona, gjendet edhe kopja e rekursit të ushtruar nga kjo palë kundër vendimit gjyqësor që kërkohet të pezullohet ekzekutimit.

16- Gjithashtu, ky Kolegj vëren se palët e tjera pjesëmarrëse në gjykimin e çështjes ku është dhënë vendimi gjyqësor që kërkohet të pezullohet, janë njoftuar rregullisht për kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese Shpëtim Gjona, të cilat nuk kanë parashtruar argumente lidhur me bazueshmërinë në ligj të kërkesës për pezullim dhe për qëndrimin e tyre.

17- Nga shqyrtimi i shkaqeve konkrete për të cilat pala kërkuese Shpëtim Gjona kërkon pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, Kolegji Administrativ vlerëson se, kjo Kërkesë, në tërësinë e saj, motivohet me shkaqe që kanë të bëjnë vetëm me drejtësinë, bazueshmërinë në prova dhe në ligj, të vendimeve të dhëna nga gjykata administrative e shkallës së parë dhe ajo e Apelit në zgjidhjen e çështjes, të cilat ky Kolegj i vlerëson në kohën kur shqyrton në dhomë këshillimi shkaqet e rekursit ndaj vendimit të gjykatës administrative të apelit.

18- Për sa i përket motivit të fundit dhe të vetëm, që formalisht përfshihet në rastin e shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, Kolegji Administrativ vëren se pala kërkuese Shpëtim Gjona nuk ka paraqitur asnjë provë dhe nuk ka arsyetuar lidhur me ndonjë rrethanë konkrete për ta vlerësuar nëse jemi ose jo përpara rastit kur Gjykata e Lartë mund të konkludojë se nga ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit gjyqësor do të vinin pasoja të rënda për palën kërkuese Shpëtim Gjona.

19- Kolegji Administrativ vlerëson të evidentojë se, duke mbajtur parasysh edhe natyrën e mosmarrëveshjes mes palëve, pozitën e palës kreditore dhe asaj debitore, si edhe natyrën dhe vlerën e detyrimeve që kërkohet të ekzekutohen në çështjen konkrete në shqyrtim, në interpretim dhe zbatim të drejtë të ligjit procedural, mbetet thjesht një kërkim dhe pretendim hipotetik dhe, si i tillë, i pambështetur në ligj, vetëm parashtrimi formal i pretendimit (shkakut) se ekzekutimi mund të sjellë pasoja të rënda, si një shkak që e përcakton vetë neni 479 pika 1 shkronja “a” e Kodit të Procedurës Civile, pa parashtruar njëkohësisht edhe argumenta dhe shpjegime konkrete lidhur me rrethanat që tregojnë mundësinë e ardhjes së tyre.

20- Ky Kolegj, vlerëson të theksojë qëndrimin e Gjykatës së Lartë, e cila çon automatikisht në rrëzimin e kërkesës si të pambështetur në ligj, se kërkesa për pezullimin e ekzekutimit, mund të vendoset kur kemi të bëjmë me vendime gjyqësore që mbartin detyrime për palët. Në rastin konkret jemi para rastit kur kërkesa është rrëzuar nga ana e gjykatës dhe nuk ka ngarkuar me detyrime asnjë nga palët ndërgjyqëse.

21- Nga ana tjetër Ky Kolegj, njëkohësisht konstaton se kërkesa objekt gjykimi është haptazi abuzive, për vetë faktin se kërkohet të pezullohet nga pala paditëse vendimi i Gjykatës së Apelit që ka vendosur rrëzimin e padisë dhe nuk përmban detyrime për palët. Vendimi i rrëzimit të padisë, sikurse vendimet jopërfundimtare

të gjykatës, passjellin si pasojë automatike ligjore edhe detyrimin e palës paditëse që të paguajë shpenzimet gjyqësore, përveç kur palët kanë marrëveshje dhe në të kanë parashikuar ndryshe. Në kushtet kur pala kërkuese nuk e ka kontestuar këtë pjesë të vendimit të gjykatës së apelit me argumente konkret, Kolegji Administrativ konstaton se kërkesa për pezullim, që i referohet nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, në rastin konkret që lidhet me pezullimin e vendimit gjyqësor që ka rrëzuar padinë përbën abuzim me të drejtat procedurale.

22- Kolegji Administrativ sjellë në vëmendje se si rregull i përgjithshëm vendimet e rrëzimit të padisë nuk mund të përbëjnë tituj ekzekutiv sipas nenit 510 shkronja “a” të Kodit të Procedurës Civile dhe se për rrjedhojë përjashtohet apriori mundësia që ato të ekzekutohen dhe të sjellin rrezik apo pasoja të parikuperueshme në të drejtat subjektive dhe interesat e ligjshëm të palës rekursuese dhe njëkohësisht kërkuese. Në rastin konkret, Kolegji vlerëson se kërkesa për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor që ka rrëzuar padinë, jo vetëm që nuk ka lidhje me interesin e kërkuetit, por as nuk shmang ndonjë dëm për kërkuetin, përderisa vendimi nr.24 datë 11.11.2016 i IKMT që ka vendosur prishjen e objektit dhe vendimi nr.28 datë 11.11.2016 për dënimin me 500.000 lekë gjobë, janë akte administrative të ekzekutueshëm në çdo kohë.

23. Referuar parimeve të përgjithshme mbi ekzekutimin e aktit administrativ, veçanërisht neneve 104, pika 4 e 164 e vijuese të Kodit të Procedurave Administrative, akti administrativ që ka qenë objekt gjykimi dhe nuk është anuluar apo shfuqizuar si rezultat i ushtrimit të mjeteve ligjore administrative ose gjyqësore, është i ekzekutueshëm. Pikërisht akti administrativ i nxjerr nga IKMT nuk pengohet të ekzekutohet në çdo kohë, ndërkohë që paditësi Shpëtim Gjona gabimisht kërkon të pezullohet vendimi gjyqësor që ka rrëzuar padinë e tij.

24. Në këtë kuptim, Kolegji vlerëson se pala kërkuese nuk mund të ushtrojë këtë lloj kërkimi pranë Gjykatës së Lartë, pasi sigurimi i padisë parashikuar në nenin 202 të Kodit të Procedurës Civile dhe në nenin 28 të Ligjit “Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”, dhe pezullimi i ekzekutimit të vendimit, parashikuar nga neni 479 të Kodit të Procedurës Civile, janë dy koncepte të ndryshme dhe që u përkasin shkallëve të ndryshme. Pra, paditësi konfondon haptazi kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor që ka rrëzuar padinë e tij, me atë të pezullimit të aktit administrativ.

25- Duke qenë se kjo kërkesë është haptazi e pathemeltë dhe për më tepër abuzive, Kolegji Administrativ vlerëson se është vendi të procedohet me zbatimin e pikës 1 të nenit 34 të Kodit të Procedurës Civile. Kjo dispozitë parashikon se: “1. Gjykata, në çdo shkallë të gjykimit, kur konstaton se palët ose përfaqësuesit e tyre me vetëdije paraqesin padi, ankime, kërkesa ose pretendime abuzive, ose të përsëritura dhe me keqdashje, ose kur kërkojnë qëllimisht të zvarrisin gjykimin, ose kur konstatohet se palët ose përfaqësuesit e tyre kanë fshehur ose shtrembëruar me keqbesim ose faj të rëndë, fakte dhe rrethana të rëndësishme që lidhen me çështjen, urdhëron me vendimin që jepet në përfundim të gjykimit, përveç kur në këtë Kod parashikohet ndryshe, gjobitjen e përgjegjësitet në shumën nga 50 000 deri në 100 000 lekë. Kundër këtij vendimi lejohet ankim sipas rregullave për vendimet përfundimtare ose jopërfundimtare, në varësi të llojit të vendimit që i jep fund gjykimit përkatës.”

26- Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se kjo pjesë e dispozitës ka synuar të aktivizojë përgjegjësinë e palëve dhe përfaqësuesve të tyre të cilët abuzojnë me të drejtat procedurale. Mjetet procedurale dhe të drejtat që ligji ofron nuk mund të pranohen të

lejojnë dëmtimin e procesit të dhënies së drejtësisë. Ato nuk mund të shndërrohen në mekanizma që palët dhe përfaqësuesit e tyre t'i përdorin me keqbesim apo me qëllime të pamundësisë së zhvillimit të procesit apo dëmtimit të interesave dhe të drejtës së palës kundërshtare për të gëzuar efektivisht aksesin në drejtësi. Për rrjedhojë sa herë që konstatohen fakte të tilla të paligjshme në mënyrën se si një ndërgjyqës mbrohet apo e ushtron aktivitetin procedural gjykata duhet të sanksionojë përgjegjësinë pasurore për shkelje të këtij detyrimi ligjor. Qëllimi i kësaj norme është garantimi i mbarëvajtjes së procesit gjyqësor dhe detyrimi i subjekteve procedurale, qoftë ndërgjyqës apo qoftë përfaqësues, që të veprojnë dhe të ushtrojnë me mirëbesim të drejtat procedurale.

27- Gjykimi në Gjykatën e Lartë në këtë drejtim paraqet dy veçanti. Fillimisht duhet të mbahet parasysh se neni 474 i Kodit të Procedurës Civile parashikon se rekursi i paraqitur në Gjykatën e Lartë duhet të nënshkruhet nga avokati që e përfaqëson palën dhe nëse pala e kërkon, edhe nga kjo e fundit. Nga ana tjetër neni 59 i Ligjit nr. 49/2012 parashikon se edhe kundërrkursi duhet të plotësojë kushtet formale që paraqet rekursi. Kjo do të thotë se qoftë mjetet e ankimit dhe qoftë mjetet e prejardhura të ankimit do të duhet të realizohen nga avokati në Gjykatën e Lartë, si një gjykatë ekskluzivisht me juridiksion të posaçëm ligjor. Nga këto parashikime konkludohet se aktet që i drejtohen Gjykatës së Lartë dhe që përbëjnë disponim të të drejtave procedurale të palëve aktivizojnë detyrimisht edhe përgjegjësinë e përfaqësuesit të palës. Ndaj këto të fundit janë personalisht përgjegjës sipas nenit 34 të Kodit të Procedurës Civile.

28- Nga ana tjetër, gjykimi në Gjykatën e Lartë, në rastin e zbatimit të sanksionit të parashikuar në nenin 34, pika 1 të Kodit të Procedurës Civile, nuk mundëson ushtrimin e ankimit të veçantë ndaj gjobës prej 50.000 Lekë – 100.000 Lekë që kjo gjykatë vendos. Në këto raste ankimi i veçantë që kjo dispozitë ofron nuk mund të zbatohet, pasi vendimi i Gjykatës së Lartë sipas nenit 482 dhe 485 të Kodit të Procedurës Civile dhe nenit 60/a dhe 63 të Ligjit nr. 49/2012 nuk mund të ankimohet gjyqësisht duke qenë se pushteti gjyqësor shteron pas ezaurimit të kësaj shkalle gjykimi.

29- Megjithatë Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se një palë apo përfaqësues i dënuar proceduralisht sipas pikës 1 të nenit 34 të Kodit të Procedurës Civile duhet të ketë mundësi të dëgjohet dhe të mbrohet lidhur me këtë sanksion, por se ligji procedural ka ometuar të japë një zgjidhje ligjore eksplicite në këtë drejtim. Me qëllimin që ndërgjyqësi apo përfaqësuesi i tij - i sanksionuar proceduralisht me gjobë për abuzim me të drejtat procedurale – të ketë mundësinë e një ankimi dhe mbi të gjitha të ketë mundësi të mbrohet mbi këtë vendim të Gjykatës së Lartë, Kolegji Administrativ vlerëson të nevojshme që nëpërmjet interpretimit pajtues të ligjit, që është në funksion të respektimit të së drejtës kushtetuese, të mos pengojë mundësinë e ankimit në gjykatë, për këto raste. Në bazë dhe për zbatim të paragrafit të dytë të nenit 1 të Kodit të Procedurës Civile, Kolegji Administrativ vlerëson se si zgjidhje në këtë rast duhet të ofrohet mjeti i posaçëm i ankimit i parashikuar në nenin 169 të Kodit të Procedurës Civile. Kjo dispozitë nën titullin “Kundërshtimi i vendimit të dënimit” parashikon se: “Personat që janë dënuar me gjobë, sipas dispozitave të mësipërme, mund t'i paraqitin gjykatës që i ka dënuar, brenda tri ditëve, kërkesë për heqjen e dënimit, duke treguar dhe shkaqet. Gjykata kur i gjen me vend këto shkaqe, revokon vendimin e dënimit me gjobë si dhe urdhrin e sjelljes me detyrim. Ajo mund edhe vetëm të pakësojë gjobën e caktuar. Në rast të kundërt, refuzon kërkesën. Afati për të paraqitur kërkesën fillon nga dita e seancës gjyqësore dhe, në rastet e parashikuara nga nenet 165 dhe 167, nga dita e njoftimit të vendimit të dënimit. Vendimi i dhënë nga gjykata në rastet e sipërme është i formës së prerë dhe kundër tij nuk lejohet ankim.”

30- Për rrjedhojë Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë konkludon se, ndaj vendimeve të Gjykatës së Lartë, në të cilat sanksionohen dënime procedurale me gjobë për ndërgjyqësin apo përfaqësuesin e tij, sipas pikës 1 të nenit 34 të Kodit të Procedurës Civile, lejohet ankim brenda tre ditëve nga dita e nesërme e marrjes dijeni për vendimin, para të njëjtit trup gjykues që ka dhënë vendimin e dënimit, duke treguar shkaqet dhe arsyet që justifikojnë kërkesën. Gjykata e Lartë e shqyrton këtë kërkesë në dhomë këshillimi dhe sipas rastit vendos pakësimin e gjobës, pranimin apo refuzimin e kërkesës. Në çdo rast, kundër vendimit të Gjykatës së Lartë, që ka vendosur pakësimin, pranimin apo refuzimin e kërkesës, nuk lejohet ankim.

31- Në rastet e vendimmarrjes së Gjykatës së Lartë, përmes së cilave caktohet një sanksion procedural gjobor sipas pikës 1 të nenit 34 të Kodit të Procedurës Civile, një kopje e vendimit i njoftohet shërbimit përmbarrimor, konkretisht Zyrës Përmbarrimore Tiranë. Sipas shkronjës “a” të nenit 510 të Kodit të Procedurës Civile vendimet e Gjykatës së Lartë në këto raste përbëjnë tituj ekzekutiv dhe si të tilla janë të ekzekutueshme nga shërbimi përmbarrimor gjyqësor. Këto shuma detyrimi derdhen nga subjekti i dënuar debitor për llogari të buxhetit të shtetit.

32- Në rastin konkret kërkesa për pezullim është ushtruar dhe hartuar nga avokati i palës paditëse, z.Nevzat Tarelli. Për rrjedhojë Kolegji Administrativ vendos që të dënojë avokatin Nevzat Tarelli, në bazë dhe për zbatim të nenit 34 të Kodit të Procedurës Civile, me gjobë në vlerën 50.000 Lekë.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në bazë të nenit 1 pika 2 e ligjit nr.49/2012 “Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative” dhe nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile

V E N D O S I

- 1- Mospranimin e kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.(28) 8, datë 09.01.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë, lënë në fuqi me vendimin nr.1476, datë 14.05.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, të paraqitur nga Shpëtim Gjona.
- 2- Dënimin e përfaqësuesit të palës kërkuese, avokatin Nevzat Tarelli, me gjobë në vlerën 50.000 Lekë.
- 3- Ky vendim përbën titull ekzekutiv.
- 4- Ngarkohet Zyra e Përmbarrimit Tiranë për ekzekutimin e gjobës për llogari të buxhetit të shtetit.
- 5- Një kopje e këtij vendimi i njoftohet edhe Zyrës së Përmbarrimit Tiranë. Kundër pjesës së vendimit të dënimit me gjobë mund të ushtrohet ankim, brenda 3 ditëve nga dita e nesërme e marrjes dijeni të këtij vendimi, në Gjykatën e Lartë.

Tiranë, më datë 18.05.2020

**ANËTAR
ERVIN PUPE**

**ANËTAR
ILIR PANDA**

**KRYESUES
SOKOL SADUSHI**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

Nr. 156/522 i Vendimit

V E N D I M

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

**Sokol Sadushi
Ervin Pupe
Irir Panda**

**Kryesues
Anëtar
Anëtar**

Në datën 18.05.2020, mori në shqyrtim në dhomën e këshillimit çështjen administrative, që u përket palëve:

KËRKUES: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

OBJEKTI: Pezullimi i ekzekutimit të vendimit nr.1469, datë 14.05.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

BAZA LIGJORE: Neni 479 të Kodit të Procedurës Civile

Në çështjen me palë:

PADITËS: Tahir Syleci

PADITUR: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoji relacionin e gjyqtarit Sokol Sadushi dhe diskutoi çështjen në tërësi në dhomën e këshillimit,

VËREN

I- RRETHANAT E ÇËSHTJES

1- Nga aktet e administruara në praktikën gjyqësore, rezulton se pala paditëse Tahir Syleci, është ndaluar nga Policia e Shtetit dhe nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë i është dhënë masa e arrestit në burg.

2- Për sa më sipër, paditësi duke pretenduar se ka kryer burgim të padrejtë dhe i është drejtuar gjykatës me padinë objekt gjykimi.

3- **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë**, me vendimin nr.6053, datë 27.11.2015 ka vendosur:

Pranimin pjesërisht të kërkesë padisë.

Kompensimin për burgim të padrejtë të paditësit Tahir Syleci për 734 ditë paraburgimi.

Detyrimin e palës së paditur Ministria e Financave, Dega e Thesarit Tiranë, për të kompensuar paditësin Tahir Syleci në shumën 1.614.800 (një milion e gjashtëqind e katërbëdhjetë mijë e tetëqind) lekë.

Kompensimin për burgim të padrejtë të paditësit Tahir Syleci për 253 ditë arrest shtëpie.

Detyrimin e palës së paditur Ministria e Financave, Dega e Thesarit Tiranë, për të kompensuar paditësin Tahir Syleci në shumën 253.000 (dyqind e pesëdhjetë e tre mijë) lekë.

Rrëzimin e kërkesë padisë për pjesën tjetër.

4- **Gjykata Administrative e Apelit Tiranë**, me vendimin nr.1469, datë 14.05.2019 ka vendosur:

Lënien në fuqi të vendimit nr.6053, datë 27.11.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

5- Më datë **31.10.2019** Ministria e Financave dhe Ekonomisë, ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në thelb parashtron sa vijon:

- *Vendimi është i gabuar dhe i pabazuar në ligj, pasi nuk është respektuar dhe nuk është zbatuar drejtë ligji.*
- *Gjykatat kanë gabuar në caktimin e masës së kompensimit për paditësin, pasi nuk justifikohet caktimi i masës në prova konkrete.*
- *Gjykata duhet të hetojë çështjen dhe të administrojë prova, në lidhje me aspektet e dispozitës materiale, duke ia nënshtruar parimit të provueshmërisë, mbështetur në nenin 12 të K.Pr.Civile ku përcaktohet se paditësi ka barrën e provës.*
- *Ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda financiare për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.*

II- VLERËSIMI I KOLEGJIT ADMINISTRATIV TË GJYKATËS SË LARTË

6- Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

7- Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atëçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të riparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

8- Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:

a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të riparueshme; dhe/ose

b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.

9- Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- *ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të riparueshëm dhe të atëçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;*
- *(nuk) cenohet rëndë interesi publik.*

10- Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të inicuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

11- Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentat e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim.

12- Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim. Nga ana tjetër abuzimi me mjetin ligjor të parashikuar nga neni 479 i Kodit të Procedurës Civile mund të shkaktojë dhe aktivizimin e përgjegjësive personale pasurore të palës apo përfaqësuesit, sipas pikës 1 të nenit 34 të Kodit.

13- Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në funksion të zgjidhjes së çështjes konkrete, vlerëson se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë e paraqitur nga pala e paditur, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, është e pabazuar në ligj dhe si e tillë nuk duhet të pranohet.

14- Ky Kolegj vëren se, në zbatim të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, bashkëlidhur kërkesës për pezullim të palës kërkuese Ministria e Financave dhe Ekonomisë, gjendet edhe kopja e rekursit të ushtruar nga kjo palë kundër vendimit gjyqësor që kërkohet të pezullohet ekzekutimit.

15- Gjithashtu, ky Kolegj vëren se palët e tjera pjesëmarrëse në gjykimin e çështjes ku është dhënë vendimi gjyqësor që kërkohet të pezullohet, janë njoftuar rregullisht për kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese Ministria e Financave dhe Ekonomisë, të cilat nuk kanë parashtruar argumente lidhur me bazueshmërinë në ligj të kërkesës për pezullim dhe për qëndrimin e tyre.

16- Nga shqyrtimi i shkaqeve konkrete për të cilat pala kërkuese Ministria e Financave dhe Ekonomisë kërkon pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, Kolegji Administrativ vlerëson se, kjo Kërkesë, në tërësinë e saj, motivohet me shkaqe që kanë të bëjnë vetëm me drejtësinë, bazueshmërinë në prova dhe në ligj, të vendimeve të dhëna nga gjykata administrative e shkallës së parë dhe ajo e Apelit në zgjidhjen e çështjes, të cilat ky Kolegj i vlerëson në kohën kur shqyrton në dhomë këshillimi shkaqet e rekursit ndaj vendimit të gjykatës administrative të apelit.

17- Për sa i përket motivit të fundit dhe të vetëm, që formalisht përfshihet në rastin e shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, Kolegji Administrativ vëren se pala kërkuese Ministria e Financave dhe Ekonomisë nuk ka paraqitur asnjë provë dhe nuk ka arsyetuar lidhur me ndonjë rrethanë konkrete për ta vlerësuar nëse jemi ose jo përpara rastit kur Gjykata e Lartë mund të konkludojë se nga ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit gjyqësor do të vinin pasoja të rënda financiare për palën kërkuese Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

18- Kolegji Administrativ vlerëson të evidentojë se, duke mbajtur parasysh edhe natyrën e mosmarrëveshjes mes palëve, pozitën e palës kreditore dhe asaj debitore, si edhe natyrën dhe vlerën e detyrimeve që kërkohet të ekzekutohen në çështjen konkrete në shqyrtim, në interpretim dhe zbatim të drejtë të ligjit procedural, mbetet thjesht një kërkim dhe pretendim hipotetik dhe, si i tillë, i pambështetur në ligj, vetëm parashtrimi formal i pretendimit (shkakut) se ekzekutimi mund të sjellë pasoja të rënda financiare, si një shkak që e përcakton vetë neni 479 pika 1 shkronja “a” e Kodit të Procedurës Civile, pa parashtruar njëkohësisht edhe argumenta dhe shpjegime konkrete lidhur me rrethanat që tregojnë mundësinë e ardhjes së tyre.

19- Për sa më sipër, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se nuk ka vend për të pranuar kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese Ministria e Financave dhe Ekonomisë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.1469, datë 14.05.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në bazë të nenit 1 pika 2 e ligjit nr.49/2012 “Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative” dhe nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile

V E N D O S I

Mospranimin e kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.1469, datë 14.05.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, të paraqitur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Tiranë, më datë 18.05.2020

**ANËTAR
ERVIN PUPE**

**ANËTAR
ILIR PANDA**

**KRYESUES
SOKOL SADUSHI**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

Nr. 160/526 i Vendimit

V E N D I M

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

Sokol Sadushi	Kryesues
Ervin Pupe	Anëtar
Ilir Panda	Anëtar

Në datën 18.05.2020, mori në shqyrtim në dhomën e këshillimit çështjen administrative, që u përket palëve:

KËRKUES: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

OBJEKTI: Pezullimi i ekzekutimit të vendimit nr.2548, datë 26.09.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

BAZA LIGJORE: Neni 479 të Kodit të Procedurës Civile

Në çështjen me palë:

PADITËS: Abaz Rohani

PADITUR: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoji relacionin e gjyqtarit Sokol Sadushi dhe diskutoi çështjen në tërësi në dhomën e këshillimit,

VËREN

I- RRETHANAT E ÇËSHTJES

1- Nga aktet e administruara në praktikën gjyqësore, rezulton se pala paditëse Abaz Rohani, është ndaluar nga Policia e Shtetit për akuzën e “Falsifikimit të monedhave” dhe nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë i është dhënë masa e arrestit në burg.

2- Për akuzën e sipërcituar Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka vendosur ta deklaroj fajtor palën paditëse, për veprën penale që i atribuohet, vendim ky i cili është prishur nga Gjykata e Apelit Vlorë e cila ka vendosur prishjen e këtij vendimi i cili ka deklaruar e fajtor palën paditëse.

3- Për sa më sipër, paditësi duke pretenduar se ka kryer burgim të padrejtë dhe i është drejtuar gjykatës me padinë objekt gjykimi.

4- **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë**, me vendimin nr.532, datë 14.04.2017 ka vendosur:

Pranimin pjesërisht të kërkesë padisë.

Detyrimin e palëve të paditura Zyrës së Thesarit Vlorë të shpërblejë paditësin Abaz Rohani në shumën prej 442.500 (katërqind e dyzet e dy mijë e pesëqind) lekë si kompensim për burgim të padrejtë për 295 ditë paraburgim.

Rrëzimin për pjesën tjetër të padisë.

5- **Gjykata Administrative e Apelit Tiranë**, me vendimin nr.2548, datë 26.09.2019 ka vendosur:

Lënien në fuqi të vendimit nr.532, datë 14.04.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.

6- Më datë **25.12.2019** Ministria e Financave dhe Ekonomisë, ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në thelb parashtron sa vijon:

- *Vendimi është i gabuar dhe i pabazuar në ligj, pasi nuk është respektuar dhe nuk është zbatuar drejtë ligji.*
- *Gjykatat kanë gabuar në caktimin e masës së kompensimit për paditësin, pasi nuk justifikohet caktimi i masës në prova konkrete.*
- *Gjykata duhet të hetojë çështjen dhe të administrojë prova, në lidhje me aspektet e dispozitës materiale, duke ia nënshtruar parimit të provueshmërisë, mbështetur në nenin 12 të K.Pr.Civile ku përcaktohet se paditësi ka barrën e provës.*
- *Ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda financiare për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.*

II- VLERËSIMI I KOLEGJIT ADMINISTRATIV TË GJYKATËS SË LARTË

7- Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënie të vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

8- Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i

subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atëçastshëm dhe eminent për shkakimin e një dëmi të rëndë dhe të riparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

9- Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:

a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të riparueshme; dhe/ose

b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.

10- Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- *ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të riparueshëm dhe të atëçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;*
- *(nuk) cenohet rëndë interesi publik.*

11- Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të inicuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

12- Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentat e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Si rregull i përgjithshëm nuk janë të mjaftueshme vetëm shkaqet ligjore të përmbajtjes së rekursit për të pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi shqyrtimi në themel i rekursit ndryshon nga shqyrtimi i kërkesës për pezullim.

13- Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim. Nga ana tjetër abuzimi me mjetin ligjor të parashikuar nga neni 479 i Kodit të Procedurës Civile mund të shkaktojë dhe aktivizimin e përgjegjësive personale pasurore të palës apo përfaqësuesit, sipas pikës 1 të nenit 34 të Kodit.

14- Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në funksion të zgjidhjes së çështjes konkrete, vlerëson se kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë e paraqitur nga pala e paditur, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, është e pabazuar në ligj dhe si e tillë nuk duhet të pranohet.

15- Ky Kolegj vëren se, në zbatim të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, bashkëlidhur kërkesës për pezullim të palës kërkuese Ministria e Financave dhe Ekonomisë, gjendet edhe kopja e rekursit të ushtruar nga kjo palë kundër vendimit gjyqësor që kërkohet të pezullohet ekzekutimit.

16- Gjithashtu, ky Kolegj vëren se palët e tjera pjesëmarrëse në gjykimin e çështjes ku është dhënë vendimi gjyqësor që kërkohet të pezullohet, janë njoftuar rregullisht për kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese Ministria e Financave dhe Ekonomisë, të cilat nuk kanë parashtruar argumente lidhur me bazueshmërinë në ligj të kërkesës për pezullim dhe për qëndrimin e tyre.

17- Nga shqyrtimi i shkaqeve konkrete për të cilat pala kërkuese Ministria e Financave dhe Ekonomisë kërkon pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, Kolegji Administrativ vlerëson se, kjo Kërkesë, në tërësinë e saj, motivohet me shkaqe që kanë të bëjnë vetëm me drejtësinë, bazueshmërinë në prova dhe në ligj, të vendimeve të dhëna nga gjykata administrative e shkallës së parë dhe ajo e Apelit në zgjidhjen e çështjes, të cilat ky Kolegj i vlerëson në kohën kur shqyrton në dhomë këshillimi shkaqet e rekursit ndaj vendimit të gjykatës administrative të apelit.

18- Për sa i përket motivit të fundit dhe të vetëm, që formalisht përfshihet në rastin e shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, Kolegji Administrativ vëren se pala kërkuese Ministria e Financave dhe Ekonomisë nuk ka paraqitur asnjë provë dhe nuk ka arsyetuar lidhur me ndonjë rrethanë konkrete për ta vlerësuar nëse jemi ose jo përpara rastit kur Gjykata e Lartë mund të konkludojë se nga ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit gjyqësor do të vinin pasoja të rënda financiare për palën kërkuese Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

19- Kolegji Administrativ vlerëson të evidentojë se, duke mbajtur parasysh edhe natyrën e mosmarrëveshjes mes palëve, pozitën e palës kreditore dhe asaj debitore, si edhe natyrën dhe vlerën e detyrimeve që kërkohet të ekzekutohen në çështjen konkrete në shqyrtim, në interpretim dhe zbatim të drejtë të ligjit procedural, mbetet thjesht një kërkim dhe pretendim hipotetik dhe, si i tillë, i pambështetur në ligj, vetëm parashtrimi formal i pretendimit (shkakut) se ekzekutimi mund të sjellë pasoja të rënda financiare, si një shkak që e përcakton vetë neni 479 pika 1 shkronja “a” e Kodit të Procedurës Civile, pa parashtruar njëkohësisht edhe argumenta dhe shpjegime konkrete lidhur me rrethanat që tregojnë mundësinë e ardhjes së tyre.

20- Për sa më sipër, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se nuk ka vend për të pranuar kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese Ministria e Financave dhe Ekonomisë,

për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.2548, datë 26.09.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në bazë të nenit 1 pika 2 e ligjit nr.49/2012 “Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative” dhe nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile

V E N D O S I

Mospranimin e kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr.2548, datë 26.09.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, të paraqitur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Tiranë, më datë 18.05.2020

**ANËTAR
ERVIN PUPE**

**ANËTAR
ILIR PANDA**

**KRYESUES
SOKOL SADUSHI**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

Nr. 81/400 Regj.

**V E N D I M
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i përbërë nga:

**Sokol Sadushi
Ervin Pupe
Ilir Panda**

**Kryesues
Anëtar
Anëtar**

në Tiranë, sot më **datë 18.05.2020**, mori në shqyrtim kërkesën për pezullim, në çështjen administrative me **Nr. Akti 400/2019**, që i përket:

KËRKUES: Agjencia Shtetërore e Kadastrës.

OBJEKTI: Pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 1302, datë 25.04.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit.

BAZA LIGJORE: Neni 479 i Kodit të Procedurës Civile.

Në çështjen me palë:

PADITËS: Feti Deromemaj.

E PADITUR: Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë.

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoji relacionin e gjyqtarit Sokol Sadushi dhe si e shqyrtoi çështjen në tërësi, në dhomë këshillimi, pa pjesëmarrjen e palëve;

V Ë R E N

Rrethanat e çështjes

1. Padiësi Feti Deromemaj i është drejtuar me padi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke kërkuar detyrimin e palës së paditur, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë (sot Agjencia Shtetërore e Kadastrës), që ta dëmshpërblejë për zgjidhjen e menjëhershme dhe të pajustificuar të kontratës së punës, për mosrespektimin e procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës si dhe ta shpërblejë për vjetërsinë në punë.

2. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 6488 (4782), datë 22.12.2015, ka vendosur:

- *Pranimin e kërkesëpadisë së palës paditëse Feti Deromemaj, si të bazuar në prova dhe në ligj.*
- *Detyrimin e palës së paditur Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme t'i paguajë paditësit Feti Deromemaj një dëmshpërblim prej 7 (shtatë) pagash mujore, për zgjidhje me efekt të menjëhershëm të kontratës së punës pa shkaqe të justifikuara.*
- *Detyrimin e palës së paditur Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme t'i paguajë paditësit Feti Deromemaj një dëmshpërblim prej 2 (dy) pagash mujore, për shkak të mosrespektimit të afatit të njoftimit në zgjidhjen e kontratës së punës.*
- *Detyrimin e palës së paditur Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme t'i paguajë paditësit Feti Deromemaj një dëmshpërblim prej 2 (dy) pagash mujore, për shkak të mosrespektimit të procedurës së zgjidhjes së marrëdhënies së punës në masën e 2 (dy) pagave mujore.*
- *Detyrimin e palës së paditur Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme t'i paguajë paditësit Feti Deromemaj 1.5 paga mujore si shpërblim për vjetërsinë.*

3. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 1302, datë 25.04.2019, ka vendosur:

- *Lënien në fuqi të vendimit nr. 6488, datë 04.07.25016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.*

4. Kundër vendimit nr. 1302, datë 25.04.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit, ka paraqitur rekurs pala e paditur, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, e cila ka kërkuar ndryshimin e këtij vendimi si dhe të vendimit nr. 6488 (4782), datë 22.12.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, dhe rrëzimin e padisë.

5. Pala e paditur, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, në datën 21.08.2019, ka paraqitur përpara Gjykatës së Lartë kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 6488 (4782), datë 22.12.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. 1302, datë 25.04.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit, duke parashtruar këto shkaqe:

- Ekzekutimi i vendimit nr. 1302, datë 25.04.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit, do të sillte pasoja të rënda financiare për Zyrën Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë.

Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

6. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

7. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atëçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të

pariparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

8. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:

a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme; dhe/ose

b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.

9. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të pariparueshëm dhe të atëçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;
- (nuk) cenohet rëndë interesi publik.

10. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të iniciuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

11. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentet e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim.

12. Së pari, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë konstaton se nga ana e kërkuesit është bërë rekurs ndaj vendimit nr. 1302, datë 25.04.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit, si kushti që e legjitimon këtë subjekt për paraqitjen e kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të formës së prerë.

13. Së dyti, ky Kolegj konstaton se kërkesa e paraqitur nga pala e paditur, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 6488 (4782), datë 22.12.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. 1302, datë 25.04.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit, nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 479 të Kodit të Procedurës Civile.

14. Në kërkesën e paraqitur prej tij, kërkuesi parashtron një shkak gjenerik, pasojat e rënda financiare që do të paraqiste për të ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit, pa dhënë shpjegime dhe argumente se cilat do të ishin këto pasoja konkrete financiare dhe se në ç'mënyrë do të shkaktoheshin nga ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit. Kërkesa për

pezullimin e ekzekutimit të një vendimi të formës së prerë duhet t'i referohet një shkaku konkret, i cili duhet të arsyetohet mjaftueshëm nga ana e kërkuetit.

15. Në të njëjtën kohë, kërkueti nuk ka paraqitur asnjë provë në mbështetje të pretendimit të tij për dëmin e rëndë financiar. Ardhja e pasojave me natyrë financiare është një fakt i provueshëm. Për më tepër, referuar nenit 12 të Kodit të Procedurës Civile, pala që pretendon një të drejtë ka detyrimin të provojë faktet mbi të cilat ajo mbështet pretendimet e saj.

16. Për sa u përket më sipër, kërkesa e paraqitur nga pala e paditur, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 6488 (4782), datë 22.12.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. 1302, datë 25.04.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit, nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 479 të Kodit të Procedurës Civile.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, bazuar në nenin 1, pika 2, të ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" si dhe nenin 479 të Kodit të Procedurës Civile;

V E N D O S I

Mospranimin e kërkesës së paraqitur nga pala e paditur, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 6488 (4782), datë 22.12.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. 1302, datë 25.04.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit.

Tiranë, më 18.05.2020

A N Ë T A R
Ilir PANDA

A N Ë T A R
Ervin PUPE

K R Y E S U E S
Sokol SADUSHI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

Nr. 66/371 i Vendimit.

**V E N D I M
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i përbërë nga:

Sokol Sadushi	Kryesues
Ervin Pupe	Anëtar
Ilir Panda	Anëtar

në Tiranë, sot më **datë 18.05.2020**, mori në shqyrtim kërkesën për pezullim, në çështjen administrative me **Nr. Akti 371/2019**, që i përket:

KËRKUES: Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë.

OBJEKTI: Kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 1449, datë 09.05.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

BAZA LIGJORE: Neni 479/a i Kodit të Procedurës Civile.

Në çështjen me palë:

PADITËS: Flamur Lalo.

E PADITUR: Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë.

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoji relacionin e gjyqtarit Sokol Sadushi dhe si e shqyrtoi çështjen në tërësi, në dhomë këshillimi, pa pjesëmarrjen e palëve;

V Ë R E N

Rrethanat e çështjes

1. Paditësi Flamur Lalo i është drejtuar me padi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke kërkuar detyrimin e palës së paditur, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë, që t'i rillogarisë pensionin e parakohshëm për vjetërsi shërbimi si dhe t'i paguajë diferencat që rrjedhin nga kjo rillogaritje.

2. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 6163 (4427), datë 03.12.2015, ka vendosur:

- *Pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë.*

- *Detyrimin e palës së paditur Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë t'i paguajë paditësit Flamur Lalo shumën e papaguar të pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, në zbatim të ligjit nr. 9481, datë 16.02.2006, në shumën 346.758 lekë për periudhën nga data 01.01.2006 deri në datën 30.06.2009 dhe në shumën 509.471 për periudhën nga data 01.07.2009 deri në datën 23.05.2013.*
- *Rrëzimin e kërkesëpadisë për kërkimet e tjera si të pabazuara në ligj.*

3. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 1449, datë 09.05.2019, ka vendosur:

- *Ndryshimin e vendimit nr. 6163 (4427), datë 03.12.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.*
- *Pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë.*
- *Detyrimin e të paditurit Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë t'i paguajë paditësit Flamur Lalo pensionin e parakohshëm për vjetërsi shërbimi në Forcat e Armatosura për periudhën 14.05.2004 – 30.06.2009, në shumën 1.034.527 (një milion e tridhjetë e katër mijë e pesëqind e njëzet e shtatë) lekë, llogaritur sipas formulës 50% + 2%, pa kufizim, parashikuar në ligjin nr. 8087/1996, i ndryshuar me ligjin nr. 8521/1999 dhe ligjin nr. 9210/2004.*
- *Rrëzimin e padisë për kërkimet e tjera.*

4. Kundër vendimit nr. 1449, datë 09.05.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit, ka paraqitur rekurs pala e paditur, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë.

5. Pala e paditur, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë, në datën 22.07.2019, ka paraqitur përpara Gjykatës së Lartë kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 4080, datë 26.05.2017, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ndryshuar me vendimin nr. 1449, datë 09.05.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit, duke parashtruar këto shkaqe:

- Nisur nga faktet e reja pas hyrjes në fuqi të vendimit të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 3, datë 24.11.2016, kërkojmë rishikimin e vendimit të sipërcituar të Gjykatës Administrative të Apelit.
- Ekzekutimi i një vendimi të tillë është një precedent i rrezikshëm në dëm të fondeve të Institutit të Sigurimeve Shoqërore pasi janë fonde që përballohen nga buxheti i shtetit.

Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

6. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

7. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atëçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë

mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

8. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:

a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të riparueshme; dhe/ose

b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.

9. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të riparueshëm dhe të atëçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;
- (nuk) cenohet rëndë interesi publik.

10. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të iniciuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

11. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentet e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore pasjell mospranimin e kërkesës për pezullim.

12. Së pari, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë konstaton se nga ana e kërkuesit është bërë rekurs ndaj vendimit nr. 1449, datë 09.05.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit, si kushti që e legjitimon këtë subjekt për paraqitjen e kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të formës së prerë.

13. Së dyti, ky Kolegj konstaton se kërkesa e paraqitur nga pala e paditur, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 6163 (4427), datë 03.12.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ndryshuar me vendimin nr. 1449, datë 09.05.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit, nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 479 të Kodit të Procedurës Civile.

14. Në kërkesën e paraqitur prej tij, kërkuesi parashtron një shkak gjenerik, pasojat e rënda financiare që do të paraqiste për të ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit, pa dhënë shpjegime dhe argumente se cilat do të ishin këto pasoja konkrete financiare dhe se në ç'mënyrë do të shkaktoheshin nga ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit. Kërkesa për

pezullimin e ekzekutimit të një vendimi të formës së prerë duhet t'i referohet një shkaku konkret, i cili duhet të arsyetohet mjaftueshëm nga ana e kërkuarit.

15. Shkaku tjetër i parashtruar nga kërkuari, se vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit vjen në kundërshtim me Vendimin Unifikues nr. 3, datë 24.11.2016, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nuk përbën një shkak pezullimi por lidhet me themelin e pretendimeve që mund të parashtrohen në rekurs dhe që, si të tilla, nuk mund të merren në shqyrtim në këtë fazë të procesit dhe me këtë kërkesë.

16. Në të njëjtën kohë, kërkuari nuk ka paraqitur asnjë provë në mbështetje të pretendimit të tij për dëmin e rëndë financiar. Ardhja e pasojave me natyrë financiare është një fakt i provueshëm. Për më tepër, referuar nenit 12 të Kodit të Procedurës Civile, pala që pretendon një të drejtë ka detyrimin të provojë faktet mbi të cilat ajo mbështet pretendimet e saj.

17. Për sa u parashtrua më sipër, kërkesa e paraqitur nga pala e paditur, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 6163 (4427), datë 03.12.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ndryshuar me vendimin nr. 1449, datë 09.05.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit, nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 479 të Kodit të Procedurës Civile.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, bazuar në nenin 1, pika 2, të ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" si dhe nenin 479 të Kodit të Procedurës Civile;

V E N D O S I

Mospranimin e kërkesës së paraqitur nga pala e paditur, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 6163 (4427), datë 03.12.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ndryshuar me vendimin nr. 1449, datë 09.05.2019.

Tiranë, më 18.05.2020

A N Ë T A R
Ilir PANDA

A N Ë T A R
Ervin PUPE

K R Y E S U E S
Sokol SADUSHI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

Nr. 84/405 i Vendimit.

**V E N D I M
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i përbërë nga:

**Sokol Sadushi
Ervin Pupe
Ilir Panda**

**Kryesues
Anëtar
Anëtar**

në Tiranë, sot më **datë 18.05.2020**, mori në shqyrtim kërkesën për pezullim, në çështjen administrative me **Nr. Akti 405/2019**, që i përket:

KËRKUES: Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë.

OBJEKTI: Kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 4375, datë 27.09.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe vendimit nr. 1587, datë 23.05.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

BAZA LIGJORE: Neni 479 i Kodit të Procedurës Civile.

Në çështjen me palë:

PADITËS: Latif Zhupa.

E PADITUR: Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë.

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoji relacionin e gjyqtarit Sokol Sadushi dhe si e shqyrtoi çështjen në tërësi, në dhomë këshillimi, pa pjesëmarrjen e palëve;

V Ë R E N

Rrethanat e çështjes

1. Paditësi Latif Zhupa i është drejtuar me padi Gjykatës Administrativ të Shkallës së Parë Tiranë, duke kërkuar detyrimin e palës së paditur, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë, që t'i rillogarisë pensionin e parakohshëm për vjetërsi shërbimi si dhe t'i paguajë diferencat që rrjedhin nga kjo rillogaritje.

2. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 4375 (80-2016-4405), datë 27.09.2016, ka vendosur:

- *Pranimin e padisë.*
- *Detyrimin e palës së paditur, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë, për të rillogaritur pensionin e parakohshëm për vjetërsi shërbimi të paditësit Latif Zhupa, për periudhën 01.09.2007 deri 30.06.2009.*
- *Detyrimin e palës së paditur, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë, për t'i paguar paditësit diferencën e papaguar të pensionit të parakohshëm, nga data 01.09.2007 – 30.06.2009, në shumën 392.432 (treqind e nëntëdhjetë e dy mijë e katërqind e tridhjetë e dy) lekë.*
Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palës së paditur.

3. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 1587 (86-2018-1804), datë 23.05.2019, ka vendosur:

- *Mospranimin e ankimit të palës së palës së paditur, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë, kundër vendimit nr. 4375 (80-2016-4405), datë 27.09.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.*

4. Kundër vendimit nr. 1587 (86-2018-1804), datë 23.05.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit, ka paraqitur rekurs pala e paditur, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë, e cila ka kërkuar ndryshimin e këtij vendimi si dhe të vendimit nr. 4375 (80-2016-4405), datë 27.09.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, dhe rrezimin e padisë.

5. Pala e paditur, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë, në datën 30.08.2019, ka paraqitur përpara Gjykatës së Lartë kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 4375 (80-2016-4405), datë 27.09.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke parashtruar këto shkaqe:

- Nisur nga faktet e reja pas hyrjes në fuqi të vendimit të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 3, datë 24.11.2016, kërkojmë rishikimin e vendimit të sipërcituar të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
- Ekzekutimi i një vendimi të tillë është një precedent i rrezikshëm në dëm të fondeve të Institutit të Sigurimeve Shoqërore pasi janë fonde që përballohen nga buxheti i shtetit.

Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

6. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

7. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atëçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë

mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

8. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:

a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të riparueshme; dhe/ose

b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.

9. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të riparueshëm dhe të atëçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;
- (nuk) cenohet rëndë interesi publik.

10. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të iniciuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

11. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentet e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore pasjell mospranimin e kërkesës për pezullim.

12. Së pari, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë konstaton se nga ana e kërkuesit është bërë rekurs ndaj vendimit nr. 1587 (86-2018-1804), datë 23.05.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit, si kushti që e legjitimon këtë subjekt për paraqitjen e kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të formës së prerë.

13. Së dyti, ky Kolegj konstaton se kërkesa e paraqitur nga pala e paditur, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 4375 (80-2016-4405), datë 27.09.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 479 të Kodit të Procedurës Civile.

14. Në kërkesën e paraqitur prej tij, kërkuesi parashtron një shkak gjenerik, pasojat e rënda financiare që do të paraqiste për të ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit, pa dhënë shpjegime dhe argumente se cilat do të ishin këto pasoja konkrete financiare dhe se në ç'mënyrë do të shkaktoheshin nga ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit. Kërkesa për pezullimin e ekzekutimit të një vendimi të formës së prerë duhet t'i referohet një shkaku konkret, i cili duhet të arsyetohet mjaftueshëm nga ana e kërkuesit.

15. Shkaku tjetër i parashtruar nga kërkuesi, se vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit vjen në kundërshtim me Vendimin Unifikues nr. 3, datë 24.11.2016, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nuk përbën një shkak pezullimi por lidhet me themelin e pretendimeve që mund të parashtrohen në rekurs dhe që, si të tilla, nuk mund të merren në shqyrtim në këtë fazë të procesit dhe me këtë kërkesë.

16. Në të njëjtën kohë, kërkuesi nuk ka paraqitur asnjë provë në mbështetje të pretendimit të tij për dëmin e rëndë financiar. Ardhja e pasojave me natyrë financiare është një fakt i provueshëm. Për më tepër, referuar nenit 12 të Kodit të Procedurës Civile, pala që pretendon një të drejtë ka detyrimin të provojë faktet mbi të cilat ajo mbështet pretendimet e saj.

17. Për sa u parashtrua më sipër, kërkesa e paraqitur nga pala e paditur, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 4375 (80-2016-4405), datë 27.09.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 479 të Kodit të Procedurës Civile.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, bazuar në nenin 1, pika 2, të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” si dhe nenin 479 të Kodit të Procedurës Civile;

V E N D O S I

Mospranimin e kërkesës së paraqitur nga pala e paditur, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 4375 (80-2016-4405), datë 27.09.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Tiranë, më 18.05.2020

A N Ë T A R
Ilir PANDA

A N Ë T A R
Ervin PUPE

K R Y E S U E S
Sokol SADUSHI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

Nr. 51/337i Vendimit.

**V E N D I M
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i përbërë nga:

Sokol Sadushi	Kryesues
Ervin Pupe	Anëtar
Ilir Panda	Anëtar

në Tiranë, sot më **datë 18.05.2020**, mori në shqyrtim kërkesën për pezullim, në çështjen administrative me **Nr. Akti 337/2019**, që i përket:

KËRKUES: Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë.

OBJEKTI: Pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 5474, datë 21.12.2017, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

BAZA LIGJORE: Neni 479/a i Kodit të Procedurës Civile.

Në çështjen me palë:

PADITËS: Maksim Jaupi.

E PADITUR: Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë.

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoji relacionin e gjyqtarit Sokol Sadushi dhe si e shqyrtoi çështjen në tërësi, në dhomë këshillimi, pa pjesëmarrjen e palëve;

V Ë R E N

Rrethanat e çështjes

1. Paditësi Maksim Jaupi i është drejtuar me padi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke kërkuar detyrimin e palës së paditur, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë, që t'i rillogarisë pensionin e parakohshëm për vjetërsi shërbimi si dhe t'i paguajë diferencat që rrjedhin nga kjo rillogaritje.

2. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 6861, datë 26.11.2014, ka vendosur:

- *Pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë.*

- *Detyrimin e palës së paditur Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë t'i rillogarisë paditësit Maksim Jaupi pensionin e parakohshëm për vjetërsi shërbimi nga data e daljes në pension të parakohshëm 07.08.2005 deri në datën 01.07.2009 në përputhje me formulën e nenit 11 të ligjit nr. 8087, datë 13.03.1996, 'Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të ushtarakëve të Ministrisë së Rendit Publik dhe Shërbimit Informativ Kombëtar', i ndryshuar me ligjin nr. 8521, datë 30.07.1999, i ndryshuar me nenin 49 të ligjit nr. 9210, datë 23.03.2004 "Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura në Republikën e Shqipërisë" dhe t'i paguajë paditësit Maksim Jaupi diferencën prej 625.830 lekë për këtë periudhë.*
- *Rrëzimin e kërkesëpadisë për pjesën tjetër.*
- *Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palëve në masën e pranuar dhe të rrëzuar të padisë.*

3. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 5474, datë 21.12.2017, ka vendosur:

- *Lënien në fuqi të vendimit nr. 6861, datë 26.11.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.*

4. Kundër vendimit nr. 5474, datë 21.12.2017, të Gjykatës Administrative të Apelit, ka paraqitur rekurs pala e paditur, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë.

5. Pala e paditur, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë, në datën 24.06.2019, ka paraqitur përpara Gjykatës së Lartë kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 6861, datë 26.11.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. 5474, datë 21.12.2017, të Gjykatës Administrative të Apelit, duke parashtruar këto shkaqe:

- *Vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit vjen në kundërshtim me Vendimin Unifikues nr. 3, datë 24.11.2016, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.*
- *Ekzekutimi i një vendimi të tillë është një precedent në dëm të fondeve të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë.*

Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

6. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ" (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënie të vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

7. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atëçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

8. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit

gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:

a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme; dhe/ose

b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.

9. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të pariparueshëm dhe të atëçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;
- (nuk) cenohet rëndë interesi publik.

10. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të iniciuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

11. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentet e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim.

12. Së pari, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë konstaton se nga ana e kërkuesit është bërë rekurs ndaj vendimit nr. 5474, datë 21.12.2017, të Gjykatës Administrative të Apelit, si kushti që e legjitimon këtë subjekt për paraqitjen e kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të formës së prerë.

13. Së dyti, ky Kolegj konstaton se kërkesa e paraqitur nga pala e paditur, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 6861, datë 26.11.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. 5474, datë 21.12.2017, të Gjykatës Administrative të Apelit, nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 479 të Kodit të Procedurës Civile.

14. Në kërkesën e paraqitur prej tij, kërkuesi parashtron një shkak gjenerik, pasojat e rënda financiare që do të paraqiste për të ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit, pa dhënë shpjegime dhe argumente se cilat do të ishin këto pasoja konkrete financiare dhe se në ç'mënyrë do të shkaktoheshin nga ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit. Kërkesa për pezullimin e ekzekutimit të një vendimi të formës së prerë duhet t'i referohet një shkak konkret, i cili duhet të arsyetohet mjaftueshëm nga ana e kërkuesit.

15. Shkaku tjetër i parashtruar nga kërkuesi, se vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit vjen në kundërshtim me Vendimin Unifikues nr. 3, datë 24.11.2016, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nuk përbën një shkak pezullimi por lidhet me themelin e

pretendimeve që mund të parashtrohen në rekurs dhe që, si të tilla, nuk mund të merren në shqyrtim në këtë fazë të procesit dhe me këtë kërkesë.

16. Në të njëjtën kohë, kërkuesi nuk ka paraqitur asnjë provë në mbështetje të pretendimit të tij për dëmin e rëndë financiar. Ardhja e pasojave me natyrë financiare është një fakt i provueshëm. Për më tepër, referuar nenit 12 të Kodit të Procedurës Civile, pala që pretendon një të drejtë ka detyrimin të provojë faktet mbi të cilat ajo mbështet pretendimet e saj.

17. Për sa u parashtrua më sipër, kërkesa e paraqitur nga pala e paditur, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 6861, datë 26.11.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. 5474, datë 21.12.2017, të Gjykatës Administrative të Apelit, nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 479 të Kodit të Procedurës Civile.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, bazuar në nenin 1, pika 2, të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” si dhe nenin 479 të Kodit të Procedurës Civile;

V E N D O S I

Mospranimin e kërkesës së palës së paditur, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 6861, datë 26.11.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. 5474, datë 21.12.2017, të Gjykatës Administrative të Apelit.

Tiranë, më 18.05.2020

A N Ë T A R
Ilir PANDA

A N Ë T A R
Ervin PUPE

K R Y E S U E S
Sokol SADUSHI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

Nr. 46/329 i Vendimit.

**V E N D I M
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i përbërë nga:

Sokol Sadushi	Kryesues
Ervin Pupe	Anëtar
Ilir Panda	Anëtar

në Tiranë, sot më **datë 18.05.2020**, mori në shqyrtim kërkesën për pezullim, në çështjen administrative me **Nr. Akti 329/2019**, që i përket:

KËRKUES: Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë.

OBJEKTI: Pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 1288, datë 25.04.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

BAZA LIGJORE: Neni 479/a i Kodit të Procedurës Civile.

Në çështjen me palë:

PADITËS: Shyqyri Veizi.

E PADITUR: Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë.

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoji relacionin e gjyqtarit Sokol Sadushi dhe si e shqyrtoi çështjen në tërësi, në dhomë këshillimi, pa pjesëmarrjen e palëve;

V Ë R E N

Rrethanat e çështjes

1. Paditësi Shyqyri Veizi i është drejtuar me padi Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke kërkuar detyrimin e palës së paditur, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë, që t'i rillogarisë pensionin e parakohshëm për vjetërsi shërbimi si dhe t'i paguajë diferencat që rrjedhin nga kjo rillogaritje.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 1677, datë 24.02.2012, ka vendosur:

- *Pranimin e kërkesëpadisë.*

- *Detyrimin e palës së paditur Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë për t'i paguar paditësit Shyqyri Veizi pensionin e parakohshëm për 30 vjet vjetërsi shërbimi në masën 50% të pagës referuese mbi të cilën është derdhur kontributi për 15 vjet vjetërsi shërbimi dhe pas kësaj për çdo vit tjetër të vjetërsisë së shërbimit mbi përcaktimin e mësipërm, për 15 vjet vjetërsi shërbimi masa e pensionit shtohet me 2% të pagës referuese sipas nenit 11 të ligjit nr. 8087, datë 13.03.1996, i ndryshuar, duke filluar kjo përllogaritje nga data e lindjes së të drejtës 01.01.2005.*

3. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 1288, datë 25.04.2019, ka vendosur:

- *Ndryshimin e vendimit nr. 1677, datë 24.02.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.*
- *Pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë.*
- *Detyrimin e të paditurit Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë t'i rilllogarisë paditësit Shyqyri Veizi pensionin e parakohshëm për vjetërsi shërbimi në Forcat e Armatosura, për periudhën 01.01.2005 – 30.06.2009, sipas formulës 50% + 2%, pa kufizim, parashikuar në ligjin nr. 8087/1996, i ndryshuar me ligjin nr. 8521/1999 dhe ligjin nr. 9210/2004 dhe t'i paguajë diferencat e pensionit për këtë periudhë, duke përfshirë rritjet e miratuara me aktet nënligjore.*
- *Rrëzimin e padisë për kërkimet e tjera.*

4. Kundër vendimit nr. 1288, datë 25.04.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit, ka paraqitur rekurs pala e paditur, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë.

5. Pala e paditur, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë, në datën 17.06.2019, ka paraqitur përpara Gjykatës së Lartë kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 1677, datë 24.02.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. 1288, datë 25.04.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit, duke parashtruar këto shkaqe:

- *Vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit vjen në kundërshtim me Vendimin Unifikues nr. 3, datë 24.11.2016, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.*
- *Ekzekutimi i një vendimi të tillë është një precedent në dëm të fondeve të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë.*

Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

6. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “*Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ*” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

7. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atëçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

8. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:

a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme; dhe/ose

b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.

9. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të pariparueshëm dhe të atëçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;
- (nuk) cenohet rëndë interesi publik.

10. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të iniciuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

11. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentet e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim.

12. Së pari, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë konstaton se nga ana e kërkuesit është bërë rekurs ndaj vendimit nr. 1288, datë 25.04.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit, si kushti që e legjitimon këtë subjekt për paraqitjen e kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të formës së prerë.

13. Së dyti, ky Kolegj konstaton se kërkesa e paraqitur nga pala e paditur, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 1677, datë 24.02.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. 1288, datë 25.04.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit, nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 479 të Kodit të Procedurës Civile.

14. Në kërkesën e paraqitur prej tij, kërkuesi parashtron një shkak gjenerik, pasojat e rënda financiare që do të paraqiste për të ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit, pa dhënë shpjegime dhe argumente se cilat do të ishin këto pasoja konkrete financiare dhe se në ç'mënyrë do të shkaktoheshin nga ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit. Kërkesa për pezullimin e ekzekutimit të një vendimi të formës së prerë duhet t'i referohet një shkaku konkret, i cili duhet të arsyetohet mjaftueshëm nga ana e kërkuesit.

15. Shkaku tjetër i parashtruar nga kërkuesi, se vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit vjen në kundërshtim me Vendimin Unifikues nr. 3, datë 24.11.2016, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nuk përbën një shkak pezullimi por lidhet me themelin e pretendimeve që mund të parashtrohen në rekurs dhe që, si të tilla, nuk mund të merren në shqyrtim në këtë fazë të procesit dhe me këtë kërkesë.

16. Në të njëjtën kohë, kërkuesi nuk ka paraqitur asnjë provë në mbështetje të pretendimit të tij për dëmin e rëndë financiar. Ardhja e pasojave me natyrë financiare është një fakt i provueshëm. Për më tepër, referuar nenit 12 të Kodit të Procedurës Civile, pala që pretendon një të drejtë ka detyrimin të provojë faktet mbi të cilat ajo mbështet pretendimet e saj.

17. Për sa u parashtrua më sipër, kërkesa e paraqitur nga pala e paditur, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 1677, datë 24.02.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. 1288, datë 25.04.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit, nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 479 të Kodit të Procedurës Civile.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, bazuar në nenin 1, pika 2, të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” si dhe nenin 479 të Kodit të Procedurës Civile;

V E N D O S I

Mospranimin e kërkesës së palës së paditur, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 1677, datë 24.02.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. 1288, datë 25.04.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

Tiranë, më 18.05.2020

A N Ë T A R
Ilir PANDA

A N Ë T A R
Ervin PUPE

K R Y E S U E S
Sokol SADUSHI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

Nr. 78/394 Regj.

**V E N D I M
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i përbërë nga:

Sokol Sadushi	Kryesues
Ervin Pupe	Anëtar
Ilir Panda	Anëtar

në Tiranë, sot më **datë 18.05.2020**, mori në shqyrtim kërkesën për pezullim, në çështjen administrative me **Nr. Akti 394/2019**, që i përket:

KËRKUES: Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

OBJEKTI: Pezullimin i menjëhershëm i ekzekutimit të vendimit nr. 1893 (86-2019-2182), datë 19.06.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, dhe vendimit nr. 1250 (80-2018-1281), datë 10.04.2018, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

BAZA LIGJORE: Neni 449, 479 e vijues i Kodit të Procedurës Civile.

Në çështjen me palë:

PADITËS: Ajet Leka.
Komiteti Shqiptar i Helsinkit.

TË PADITUR: Ministria e Shëndetësisë.
Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.
Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë.

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoji relacionin e gjyqtarit Sokol Sadushi dhe si e shqyrtoi çështjen në tërësi, në dhomë këshillimi, pa pjesëmarrjen e palëve;

V Ë R E N

Rrethanat e çështjes

1. Padi tësësit Ajet Leka dhe Komiteti Shqiptar i Helsinkit i janë drejtuar me padi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke kërkuar konstatimin e diskriminimit,

në formën e “mohimit të një përshtatje të arsyeshme” për fëmijën e mitur Gisel Leka dhe detyrimin e të paditurve, Ministria e Shëndetësisë, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor dhe Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë, që të marrin të gjitha masat e nevojshme, nëpërmjet kryerjes së veprimeve të nevojshme administrative dhe pagimit të dëmshpërblimit për dëmtimin e shëndetit të tij.

2. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 1250 (80-2018-1281), datë 10.04.2018, ka vendosur:

- *Pranimin e pjesshëm të padisë.*
- *Konstatimin e diskriminimit në formën e “mohimit të një përshtatjeje të arsyeshme” ndaj fëmijës së mitur Gisel Leka.*
- *Detyrimin e palëve të paditura që solidarisht të marrin masat për shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga sjellja diskriminuese përmes riparimit të shkeljeve ligjore dhe pasojave të ardhura:*
 - *Kryerjes së veprimeve administrative për sigurimin dhe vendosjen e impiantit koklear për fëmijën e mitur me probleme të dëgjimit Gisel Leka;*
 - *Kompensimin e dëmit në formën e dëmtimit të shëndetit në masën 6.838.590 lekë.*
- *Rrëzimin e padisë për sa i përket paditësit Komiteti Shqiptar i Helsinkit për mungesë të legjitimitetit aktiv.*
Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palëve të paditura.

3. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 1893 (86-2019-2182), datë 19.06.2019, ka vendosur:

- *Lënien në fuqi të vendimit nr. 1250, datë 10.07.2018, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.*

4. Kundër vendimit nr. 1893 (86-2019-2182), datë 19.06.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit, ka paraqitur rekurs pala e paditur, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, e cila ka kërkuar prishjen e këtij vendimi si dhe të vendimit nr. 1250 (80-2018-1281), datë 10.04.2018, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, dhe pushimin e gjykimit të çështjes.

5. Pala e paditur, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, në datën 15.08.2019, ka paraqitur përpara Gjykatës së Lartë kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 1250 (80-2018-1281), datë 10.04.2018, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. 1893 (86-2019-2182), datë 19.06.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit, duke parashtruar këto shkaqe:

- Ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte një dëm të rëndë dhe të pariparueshëm për Fondin pasi cenimi dhe dobësimi i mjeteve financiare të tij do të ndikonte rëndë në cilësinë e shërbimit shëndetësor ndaj të gjithë pacientëve.
- Masa e kompensimit financiar që gjykatat kanë vendosur si detyrim për tu paguar është një vlerë jo e vogël, pasojat e të cilës do të ndjeheshin rëndë në financat e tij.
- Fondi nuk ka asnjë garanci për riparimin e pasojave dhe për rikuperimin e kësaj vlere në momentin kur Gjykata e Lartë do t'i vlerësojë të padrejta vendimet e mëparshme.

Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

6. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor

të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

7. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atëçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të riparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

8. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:

a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të riparueshme; dhe/ose

b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.

9. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të riparueshëm dhe të atëçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;
- (nuk) cenohet rëndë interesi publik.

10. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të iniciuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

11. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentet e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim.

12. Së pari, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë konstaton se nga ana e kërkuesit është bërë rekurs ndaj vendimit nr. 1893 (86-2019-2182), datë 19.06.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit, si kushti që e legjitimon këtë subjekt për paraqitjen e kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të formës së prerë.

13. Së dyti, ky Kolegj konstaton se kërkesa e paraqitur nga pala e paditur, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 1250 (80-2018-1281), datë 10.04.2018, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. 1893 (86-2019-2182), datë 19.06.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit, nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 479 të Kodit të Procedurës Civile.

14. Në kërkesën e paraqitur prej tij, kërkuesi parashtron shkaqe gjenerike, pasojat e rënda financiare që do të paraqiste për të ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit si dhe pamundësia e kthimit të shumës në rast të një vendimi të favorshëm nga Gjykata e Lartë, pa dhënë shpjegime dhe argumente se cilat do të ishin këto pasoja konkrete financiare dhe se në ç'mënyrë do të shkaktoheshin nga ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit. Kërkesa për pezullimin e ekzekutimit të një vendimi të formës së prerë duhet t'i referohet një shkaku konkret, i cili duhet të arsyetohet mjaftueshëm nga ana e kërkuesit.

15. Në të njëjtën kohë, kërkuesi nuk ka paraqitur asnjë provë në mbështetje të pretendimeve të tij për dëmin e rëndë financiar. Ardhja e pasojave me natyrë financiare është një fakt i provueshëm. Për më tepër, referuar nenit 12 të Kodit të Procedurës Civile, pala që pretendon një të drejtë ka detyrimin të provojë faktet mbi të cilat ajo mbështet pretendimet e saj.

16. Për sa u parashtrua më sipër, kërkesa e paraqitur nga pala e paditur, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 1250 (80-2018-1281), datë 10.04.2018, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. 1893 (86-2019-2182), datë 19.06.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit, nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 479 të Kodit të Procedurës Civile.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, bazuar në nenin 1, pika 2, të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” si dhe nenin 479 të Kodit të Procedurës Civile;

V E N D O S I

Mospranimin e kërkesës së paraqitur nga pala e paditur, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 1250 (80-2018-1281), datë 10.04.2018, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. 1893 (86-2019-2182), datë 19.06.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit.

Tiranë, më 18.05.2020

A N Ë T A R
Ilir PANDA

A N Ë T A R
Ervin PUPE

K R Y E S U E S
Sokol SADUSHI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

Nr. 136/490 i Vendimit.

**V E N D I M
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i përbërë nga:

**Sokol Sadushi
Ervin Pupe
Ilir Panda**

**Kryesues
Anëtar
Anëtar**

në Tiranë, sot më **datë 18.05.2020**, mori në shqyrtim kërkesën për pezullim, në çështjen administrative me **Nr. Akti 490/2019**, që i përket:

KËRKUES: Ndërmarrja “MEICO”.

OBJEKTI: Pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 4745 (80-2016-4776), datë 17.10.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. 2588, datë 01.10.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

BAZA LIGJORE: Neni 479 dhe 615 i Kodit të Procedurës Civile.

Në çështjen me palë:

PADITËS: Pashk Kaçi, Marije Kaçi, Anila Kaçi dhe Dilore Kaçi.

TË PADITUR: Ministria e Mbrojtjes, Ndërmarrja “Meico” dhe Shoqëria “Albademil” sh.p.k.

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoi relacionin e gjyqtarit Sokol Sadushi dhe si e shqyrtoi çështjen në tërësi, në dhomë këshillimi, pa pjesëmarrjen e palëve;

V Ë R E N

Rrethanat e çështjes

1. Paditësit Pashk Kaçi, Marije Kaçi, Anila Kaçi dhe Dilore Kaçi i janë drejtuar me padi Gjykatës Administrativ të Shkallës së Parë Tiranë, duke kërkuar detyrimin e të paditurve, Ministria e Mbrojtjes, Ndërmarrja “Meico” dhe Shoqëria “Albademil” sh.p.k, që tu shpërblejnë dëmin pasuror dhe jopasuror, si pasojë e shpërthimit të Gërdecit më 15.03.2008.

2. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 4745 (80-2016-4776), datë 17.10.2016, ka vendosur:

- *Pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë së paraqitur nga paditësit Pashk Kaçi, Marije Kaçi, Anila Kaçi dhe Dilore Kaçi.*
- *Detyrimin e palëve të paditura Ministria e Mbrojtjes, Ndërmarrja “Meico”, Shoqëria “Albademil” sh.p.k., që solidarisht të shpërblejë dëmin pasuror dhe jopasuror – biologjik, moral, ekzistencial, ndaj paditësit Pashk Kaçi, si pasojë e shpërthimit të Gërdecit më datë 15.03.2008, në masën 2.113.574 lekë.*
- *Detyrimin e palëve të paditura Ministria e Mbrojtjes, Ndërmarrja “Meico”, Shoqëria “Albademil” sh.p.k., që solidarisht të shpërblejë dëmin pasuror dhe jopasuror – biologjik, moral, ekzistencial, ndaj bashkëshortes së shtetasit Pashk Kaçi, shtetases Marie Kaçi si dhe secilit prej dy fëmijëve të tij Anila Kaçi dhe Dilore Kaçi, si pasojë e shpërthimit të Gërdecit më 15.03.2008, në masën 300.000 lekë për secilin nga këta tre paditës, pra gjithsej në shumën 900.000 lekë.*

3. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 2588, datë 01.10.2019, ka vendosur:

- *Lënien në fuqi të vendimit nr. 4745, datë 17.10.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.*

4. Kundër vendimit nr. 2588, datë 01.10.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit, ka paraqitur rekurs pala e paditur, Ndërmarrja “MEICO”, e cila ka kërkuar ndryshimin e këtij vendimi si dhe të vendimit nr. 4745 (80-2016-4776), datë 17.10.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, dhe rrëzimin e padisë.

5. Pala e paditur, Ndërmarrja “MEICO”, në datën 08.11.2019, ka paraqitur përpara Gjykatës së Lartë kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 4745 (80-2016-4776), datë 17.10.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. 2588, datë 01.10.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit, duke parashtruar këto shkaqe:

- Ne si palë e paditur nuk kemi legjitimitet pasiv në këtë proces gjyqësor për tu përgjigjur për dëmin që mund tu ketë ardhur paditësve.
- Përlllogaritja e bërë nga eksperti në aktin e ekspertimit është në kundërshtim me ligjin dhe praktikën dhe ne e kemi kundërshtuar.
- Nga ana e shërbimit përmbartimor ndaj nesh janë duke u ekzekutuar shumë vendime dhe, nëse do të vazhdohet me këtë ritëm, nisur edhe nga vlerat e larta të dëmshpërblimeve, kjo ndërmarrje do të shkojë drejt falimentimit.
- Ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme për Ndërmarrjen “MEICO” dhe rregullimi i këtyre pasojave do të ishte tepër i vështirë nëse Gjykata e Lartë do të konstatonte shkeljet e pretenduara nga ana jonë.

Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

6. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

7. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atëçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

8. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:

a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme; dhe/ose

b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.

9. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të pariparueshëm dhe të atëçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;
- (nuk) cenohet rëndë interesi publik.

10. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të iniciuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

11. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentet e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim.

12. Së pari, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë konstaton se nga ana e kërkuesit është bërë rekurs ndaj vendimit nr. 2588, datë 01.10.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit, si kushti që e legjitimon këtë subjekt për paraqitjen e kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të formës së prerë.

13. Së dyti, ky Kolegj konstaton se kërkesa e paraqitur nga pala e paditur, Ndërmarrja “MEICO”, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 4745 (80-2016-4776), datë 17.10.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me vendimin

nr. 2588, datë 01.10.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit, nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 479 të Kodit të Procedurës Civile.

14. Në kërkesën e paraqitur prej tij, kërkuesi parashtron një shkak gjenerik, pasojat e rënda financiare që do të paraqiste për të ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit, pa dhënë shpjegime dhe argumente se cilat do të ishin këto pasoja konkrete financiare dhe se në ç'mënyrë do të shkaktoheshin nga ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit. Kërkesa për pezullimin e ekzekutimit të një vendimi të formës së prerë duhet t'i referohet një shkak konkret, i cili duhet të arsyetohet mjaftueshëm nga ana e kërkuesit.

15. Shkaku tjetër i parashtruar nga kërkuesi, për bazueshmërinë në ligj të vendimeve të gjykatave, nuk përbën një shkak pezullimi por lidhet me themelin e pretendimeve që mund të parashtrohen në rekurs dhe që, si të tilla, nuk mund të merren në shqyrtim në këtë fazë të procesit dhe me këtë kërkesë.

16. Në të njëjtën kohë, kërkuesi nuk ka paraqitur asnjë provë në mbështetje të pretendimit të tij për dëmin e rëndë financiar. Ardhja e pasojave me natyrë financiare është një fakt i provueshëm. Për më tepër, referuar nenit 12 të Kodit të Procedurës Civile, pala që pretendon një të drejtë ka detyrimin të provojë faktet mbi të cilat ajo mbështet pretendimet e saj.

17. Për sa u parashtrua më sipër, kërkesa e paraqitur nga pala e paditur, Ndërmarrja "MEICO", për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 4745 (80-2016-4776), datë 17.10.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. 2588, datë 01.10.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit, nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 479 të Kodit të Procedurës Civile.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, bazuar në nenin 1, pika 2, të ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" si dhe nenin 479 të Kodit të Procedurës Civile;

V E N D O S I

Mospranimin e kërkesës së paraqitur nga pala e paditur, Ndërmarrja "MEICO", për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 4745 (80-2016-4776), datë 17.10.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. 2588, datë 01.10.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit.

Tiranë, më 18.05.2020

A N Ë T A R
Ilir PANDA

A N Ë T A R
Ervin PUPE

K R Y E S U E S
Sokol SADUSHI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

Nr. 87/413 i Vendimit.

**V E N D I M
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i përbërë nga:

Sokol Sadushi	Kryesues
Ervin Pupe	Anëtar
Ilir Panda	Anëtar

në Tiranë, sot më **datë 18.05.2020**, mori në shqyrtim kërkesën për pezullim, në çështjen administrative me **Nr. Akti 413/2019**, që i përket:

KËRKUES: Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

OBJEKTI: Kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 1978, datë 25.06.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

BAZA LIGJORE: Nenet 449, 479/a të Kodit të Procedurës Civile.

Në çështjen me palë:

PADITËS: Leonard Buci.

E PADITUR: Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoi relacionin e gjyqtarit Sokol Sadushi dhe si e shqyrtoi çështjen në tërësi, në dhomë këshillimi, pa pjesëmarrjen e palëve;

V Ë R E N

Rrethanat e çështjes

1. Paditësi Leonard Buci i është drejtuar me padi Gjykatës Administrativ të Shkallës së Parë Tiranë, duke kërkuar detyrimin e palës së paditur, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, që ta kompensojë për burgimin e padrejtë të vuajtur prej tij.

2. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 3811, datë 25.10.2018, ka vendosur:

- *Pranimin e kërkesëpadisë.*

- *Detyrimin e të paditurve Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Dega e thesarit Tiranë ta kompensojnë solidarisht paditësin Leonard Buci për paraburgim të padrejtë në masën 1.044.400 (një milion e dyzet e katër mijë e katërqind) lekë.*

3. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 1978 (86-2019-2277), datë 25.06.2019, ka vendosur:

- *Lënien në fuqi të vendimit nr. 3811, datë 25.10.2018, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.*

4. Kundër vendimit nr. 1978 (86-2019-2277), datë 25.06.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit, ka paraqitur rekurs pala e paditur, pala e paditur Ministria e Financave dhe Ekonomisë, e cila ka kërkuar prishjen e këtij vendimi dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në këtë gjykatë, me tjetër trup gjykues.

5. Pala e paditur, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në datën 09.09.2019, ka paraqitur përpara Gjykatës së Lartë kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 3811, datë 25.10.2018, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. 1978 (86-2019-2277), datë 25.06.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit, duke parashtruar këto shkaqe:

- Vendimet e gjykatave janë marrë në interpretim të gabuar të kuadrit ligjor dhe në përlllogaritjen e masës së dëmshpërblimit që i kanë akorduar paditësit.
- Tavanet vjetore buxhetore për çdo institucion nuk mund të parashikojnë dhe as të planifikojnë vendimet e gjykatave në vlerë monetare.
- Në rast se do ta ekzekutohej ky vendim do të ishte e vështirë rikuperimi i shumës së tij në rastin e një vendimi të Gjykatës së Lartë që do të prishte këtë vendim.
- Ekzekutimi i menjëhershëm i këtij vendimi do të sillte pasoja të rënda e të parikuperueshme për Ministrinë e Financave dhe e Ekonomisë.
- Në rast se vendimi i Gjykatës së Lartë do të jetë në favor të paditësit, vendimi do të ekzekutohet në mënyrë të menjëhershme.

Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

6. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “*Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ*” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

7. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atëçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

8. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:

a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme; dhe/ose

b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin të vendimit.”.

9. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të pariparueshëm dhe të atëçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;
- (nuk) cenohet rëndë interesi publik.

10. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të iniciuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

11. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentet e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim.

12. Së pari, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë konstaton se nga ana e kërkuesit është bërë rekurs ndaj vendimit nr. 1978 (86-2019-2277), datë 25.06.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit, si kushti që e legjitimon këtë subjekt për paraqitjen e kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të formës së prerë.

13. Së dyti, ky Kolegji konstaton se kërkesa e paraqitur nga pala e paditur, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 3811, datë 25.10.2018, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. 1978 (86-2019-2277), datë 25.06.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit, nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 479 të Kodit të Procedurës Civile.

14. Në kërkesën e paraqitur prej tij, kërkuesi parashtron një shkak gjenerik, pasojat e rënda financiare që do të paraqiste për të ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit, pa dhënë shpjegime dhe argumente se cilat do të ishin këto pasoja konkrete financiare dhe se në ç’mënyrë do të shkaktoheshin nga ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit. Kërkesa për pezullimin e ekzekutimit të një vendimi të formës së prerë duhet t’i referohet një shkaku konkret, i cili duhet të arsyetohet mjaftueshëm nga ana e kërkuesit.

15. Shkaku tjetër i parashtruar nga kërkuesi, se vendimet e gjykatave janë dhënë në kundërshtim me ligjin procedural dhe material, nuk përbën një shkak pezullimi por lidhet me themelin e pretendimeve që mund të parashtrohen në rekurs dhe që, si të tilla, nuk mund të merren në shqyrtim në këtë fazë të procesit dhe me këtë kërkesë.

16. Në të njëjtën kohë, kërkuesi nuk ka paraqitur asnjë provë në mbështetje të pretendimit të tij për dëmin e rëndë financiar. Ardhja e pasojave me natyrë financiare është një fakt i provueshëm. Për më tepër, referuar nenit 12 të Kodit të Procedurës Civile, pala që pretendon një të drejtë ka detyrimin të provojë faktet mbi të cilat ajo mbështet pretendimet e saj.

17. Për sa u parashtrua më sipër, kërkesa e paraqitur nga pala e paditur, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 3811, datë 25.10.2018, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. 1978 (86-2019-2277), datë 25.06.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit, nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 479 të Kodit të Procedurës Civile.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, bazuar në nenin 1, pika 2, të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” si dhe nenin 479 të Kodit të Procedurës Civile;

V E N D O S I

Mospranimin e kërkesës së paraqitur nga pala e paditur, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 3811, datë 25.10.2018, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. 1978 (86-2019-2277), datë 25.06.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit.

Tiranë, më 18.05.2020

A N Ë T A R
Ilir PANDA

A N Ë T A R
Ervin PUPE

K R Y E S U E S
Sokol SADUSHI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

Nr. 208 i Vendimit.

**V E N D I M
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i përbërë nga:

Sokol Sadushi	Kryesues
Ervin Pupe	Anëtar
Ilir Panda	Anëtar

në Tiranë, sot më **datë 18.05.2020**, mori në shqyrtim kërkesën për pezullim, në çështjen administrative me **Nr. Akti 208/2020**, që i përket:

KËRKUES: Myslim Gjyzeli.

OBJEKTI: Pezullimi i ekzekutimit të vendimit nr. 2779 (86-2019-3162), datë 22.10.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë .

BAZA LIGJORE: Neni 479 i Kodit të Procedurës Civile.

Në çështjen me palë:

PADITËS: Komisioni Vendor i Verifikimit të Titujve të Pronësisë, Prefektura e Qarkut Durrës.

TË PADITUR: 1. Bashkia Sukth.
2. Myslim Gjyzeli.

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoji relacionin e gjyqtarit Sokol Sadushi dhe si e shqyrtoi çështjen në tërësi, në dhomë këshillimi, pa pjesëmarrjen e palëve;

V Ë R E N

Rrethanat e çështjes

1. Paditësi Komisioni Vendor i Verifikimit të Titujve të Pronësisë, Prefektura e Qarkut Durrës i është drejtuar me padi Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, duke kërkuar pavlefshmërinë e aktit të marrjes së tokës në pronësi nr. 391, datë 30.04.1996, të të paditurit Myslim Gjyzeli.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. 11-2011-5719 (2887), datë 15.11.2011, ka vendosur:

- *Rrëzimin e kërkesëpadisë të Komisionit Vendor të Verifikimit të Titujve të Pronësisë, pranë Prefekturës së Qarkut Durrës, me objekt pavlefshmërinë e aktit administrativ të aktit të marrjes së tokës në pronësi nr. 391, datë 30.04.1996 të Shtetasit Myslim Hamid Gjyzeli, anulimin e tij, kthimin e pronës në pronësi të shtetit.*
- *Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palës paditëse.*

3. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 2779 (86-2019-3162), datë 22.10.2019, ka vendosur:

- *Ndryshimin e vendimit nr. 2887, datë 15.11.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.*
- *Pranimin e padisë së palës paditëse, Prefekti i Qarkut Durrës.*
- *Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi nr. 391, datë 30.04.1996, mbi tokën bujqësore me zë kadastral “arë”, të ndodhur në fshatin Hamallaj, Bashkia Sukth, Qarku Durrës, zona kadastrale 1925, nr. parcele 2/1, me sipërfaqe 10.000 m², në emër të të paditurit, Myslim Gjyzeli.*
- *Kthimin e kësaj pasurie në pronësi të shtetit.*

4. Kundër vendimit nr. 2779 (86-2019-3162), datë 22.10.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit, ka paraqitur rekurs pala e paditur, Myslim Gjyzeli, e cila ka kërkuar prishjen e këtij vendimi dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 11-2011-5719 (2887), datë 15.11.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

5. Pala e paditur, Myslim Gjyzeli, në datën 05.05.2020, ka paraqitur përpara Gjykatës së Lartë një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 11-2011-5719 (2887), datë 15.11.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, ndryshuar me vendimin nr. 2779 (86-2019-3162), datë 22.10.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit, duke parashtruar këto shkaqe:

- Ekzekutimi i menjëhershëm shkakton pasoja të rënda ekonomike të familjes së të paditurit Myslim Gjyzeli për shkak se mbi këtë tokë që është fituar me akt të shtetëror janë bërë investime të mëdha me një kosto që familja bujqësore e ka të vështirë që ta përballojë.
- Cenohet siguria juridike e jetës dhe e pronës si një e drejtë themelore e garantuar nga Kushtetuta dhe nga Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut.
- Pronësinë mbi këtë tokë familja Gjyzeli e ka fituar dhe me parashkrim fitues, sipas nenit 168 të Kodit Civil.
- Në rekursin që kemi paraqitur kemi argumentuar me prova dhe fakte se vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit është hapur në kundërshtim me ligjin.

Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

6. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënie të vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

7. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i

subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të ekzistojë një rrezik i atëçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

8. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:

a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme; dhe/ose

b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”.

9. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të pariparueshëm dhe të atëçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;
- (nuk) cenohet rëndë interesi publik.

10. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të iniciuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

11. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtrohet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentet e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim.

12. Së pari, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë konstaton se nga ana e kërkuesit është bërë rekurs ndaj vendimit nr. 2779 (86-2019-3162), datë 22.10.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit, si kushti që e legjitimon këtë subjekt për paraqitjen e kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të formës së prerë.

13. Së dyti, ky Kolegj konstaton se kërkesa e paraqitur nga pala e paditur, Myslim Gjyzeli, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 11-2011-5719 (2887), datë 15.11.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, ndryshuar me vendimin nr. 2779 (86-2019-3162), datë 22.10.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit, nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 479 të Kodit të Procedurës Civile.

14. Në kërkesën e paraqitur prej tij, kërkuesi parashtron një shkak gjenerik, pasojat e rënda dhe të pariparueshme ekonomike që do të pësonte ai dhe familja e tij nga ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit, pa dhënë shpjegime dhe argumente se cilat do të ishin këto pasoja konkrete financiare dhe se në ç'mënyrë do të shkaktoheshin nga ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit. Kërkesa për pezullimin e ekzekutimit të një vendimi të formës së prerë duhet t'i referohet një shkakut konkret, i cili duhet të arsyetohet mjaftueshëm nga ana e kërkuetit.

15. Shkaqet e tjera të parashtruara nga kërkuesi, për bazueshmërinë në ligj të vendimeve të gjykatave, nuk përbëjnë një shkak pezullimi por lidhen me themelin e pretendimeve që mund të parashtrohen në rekurs dhe që, si të tilla, nuk mund të merren në shqyrtim në këtë fazë të procesit dhe me këtë kërkesë.

16. Në të njëjtën kohë, kërkuesi nuk ka paraqitur asnjë provë në mbështetje të pretendimit të tij për dëmin e rëndë ekonomik. Ardhja e pasojave me natyrë ekonomike është një fakt i provueshëm. Për më tepër, referuar nenit 12 të Kodit të Procedurës Civile, pala që pretendon një të drejtë ka detyrimin të provojë faktet mbi të cilat ajo mbështet pretendimet e saj.

17. Për sa u parashtrua më sipër, kërkesa e paraqitur nga pala e paditur, Myslim Gjyzeli, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 11-2011-5719 (2887), datë 15.11.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, ndryshuar me vendimin nr. 2779 (86-2019-3162), datë 22.10.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit, nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 479 të Kodit të Procedurës Civile.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, bazuar në nenin 1, pika 2, të ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" si dhe nenin 479 të Kodit të Procedurës Civile;

V E N D O S I

Mospranimin e kërkesës së paraqitur nga pala e paditur, Myslim Gjyzeli, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 11-2011-5719 (2887), datë 15.11.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, ndryshuar me vendimin nr. 2779 (86-2019-3162), datë 22.10.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit.

Tiranë, më 18.05.2020

A N Ë T A R
Ilir PANDA

A N Ë T A R
Ervin PUPE

K R Y E S U E S
Sokol SADUSHI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

Nr. 75/389 Regj.

**V E N D I M
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i përbërë nga:

Sokol Sadushi	Kryesues
Ervin Pupe	Anëtar
Ilir Panda	Anëtar

në Tiranë, sot më **datë 18.05.2020**, mori në shqyrtim kërkesën për pezullim, në çështjen administrative me **Nr. Akti 389/2019**, që i përket:

KËRKUES: Shkolla e Mesme e Ndërtimit “Karl Gega”, Tiranë.

OBJEKTI: Pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 858 (852), datë 26.02.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. 1594, datë 23.05.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

BAZA LIGJORE: Neni 479, 615 i Kodit të Procedurës Civile.

Në çështjen me palë:

PADITËS: Luiza Liço.

E PADITUR: Shkolla e Mesme e Ndërtimit “Karl Gega”, Tiranë.

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoji relacionin e gjyqtarit Sokol Sadushi dhe si e shqyrtoi çështjen në tërësi, në dhomë këshillimi, pa pjesëmarrjen e palëve;

V Ë R E N

Rrethanat e çështjes

1. Paditësja Luiza Liço i është drejtuar me padi Gjykatës Administrativ të Shkallës së Parë Tiranë, duke kërkuar detyrimin e palës së paditur, Shkolla e Mesme e Ndërtimit “Karl Gega”, Tiranë, që ta dëmshpërblejë për zgjidhjen e menjëhershme dhe të pajustificuar të kontratës së punës, për mosrespektimin e procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës si dhe ta shpërblejë për vjetërsinë në punë.

2. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 858 (852), datë 26.02.2016, ka vendosur:

- *Pranimin e pjesshëm të kërkesëpadisë.*
- *Detyrimin e palës së paditur Shkolla Profesionale e Ndërtimit “Karl Gega”, t’i paguajë paditëses Luiza Liço pagën deri në fund të afatit të njoftimit nga data 15.10.2015 deri në datën 31.01.2016.*
- *Detyrimin e palës së paditur Shkolla Profesionale e Ndërtimit “Karl Gega”, t’i paguajë paditëses Luiza Liço një dëmshpërblim në masën e 12 (dymbëdhjetë) muajve pagë, për zgjidhje të menjëhershme dhe të pajustificuar të kontratës së punës.*
- *Detyrimin e palës së paditur Shkolla Profesionale e Ndërtimit “Karl Gega”, t’i paguajë paditëses Luiza Liço një dëmshpërblim në masën e 2 (dy) muaj pagë bruto, për mosrespektim të procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës.*
- *Detyrimin e palës së paditur Shkolla Profesionale e Ndërtimit “Karl Gega”, t’i paguajë paditëses Luiza Liço shpërblimin për vjetërsi në punë në masën e 6 (gjashtë) muaj e 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pagë bruto.*
- *Rrëzimin e padisë për pjesën tjetër të objektit të saj.*
- *Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës së paditur.*

3. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 1594, datë 23.05.2019, ka vendosur:

- *Lënien në fuqi të vendimit nr. 858 (852), datë 26.02.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.*

4. Kundër vendimit nr. 1594, datë 23.05.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit, ka paraqitur rekurs pala e paditur, Shkolla e Mesme e Ndërtimit “Karl Gega”, Tiranë, e cila ka kërkuar ndryshimin e këtij vendimi si dhe të vendimit nr. 858 (852), datë 26.02.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, dhe rrëzimin e padisë.

5. Pala e paditur, Shkolla e Mesme e Ndërtimit “Karl Gega”, Tiranë, në datën 08.08.2019, ka paraqitur përpara Gjykatës së Lartë kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 858 (852), datë 26.02.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. 1594, datë 23.05.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit, duke parashtruar këto shkaqe:

- *Vendimet e gjykatave janë dhënë në kundërshtim me ligjin procedural dhe material ndaj ato duhet të ndryshohen.*
- *Nga ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit të mësipërm mund të na vijnë pasoja të pariparueshme.*

Vlerësimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë

6. Kodi i Procedurës Civile dhe Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin administrativ” (në vijim Ligji nr. 49/2012) kanë ofruar në disponibilitetin e palëve mjete që garantojnë mbrojtje të përkohshme procedurale. Të tilla janë kërkesat e palëve mbi masat e sigurimit të padisë, sipas nenit 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile apo nenit 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, kërkesa për dhënie të vendimit me ekzekutim të përkohshëm, sipas nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile apo kërkesa për pezullimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, sipas nenit 469 dhe 479 të Kodit të Procedurës Civile. Në çdo rast këto mjete juridike të mbrojtjes së përkohshme procedurale janë të lidhura funksionalisht me mjetet kryesore të aksesit në gjykatë, qoftë padinë apo ankimet.

7. Universalisht për caktimin nga gjykata të masave të përkohshme procedurale ligji kërkon ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm se e drejta subjektive apo interesi i ligjshëm i subjektit paditës apo ankues cenohet nga veprimet apo mosveprimet e palës kundërshtare apo vendimi i gjykatës (*humus boni juris*). Nga ana tjetër kërkohet që në rrethanat e çështjes të

ekzistojë një rrezik i atëçastshëm dhe eminent për shkaktimin e një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm nëse masa e përkohshme nuk merret nga gjykata (*periculum in mora*). Në këtë mënyrë masat e përkohshme procedurale paraqiten si mjete ligjore që garantojnë standardin e efektivitetit të vetë mjetit kryesor nga i cili ato varen, konkretisht padisë dhe ankimeve.

8. Në mënyrë të posaçme neni 479 i Kodit të Procedurës Civile ka rregulluar kërkesën e palëve ndërgjyqëse, drejtuar Gjykatës së Lartë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt rekursi. Kjo dispozitë është e zbatueshme në gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë sipas nenit 1 pika 2 të Ligjit nr. 49/2012. Në pikën 1 ajo parashikon se:

“1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur:

a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme; dhe/ose

b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin e vendimit.”.

9. Përtej këtij rregullimi me karakter të përgjithshëm, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vlerëson se, në një gjykim të natyrës të së drejtës publike, siç është edhe gjykimi administrativ, është e detyrueshme për kërkuesin, ashtu si edhe për gjykatën që do të vlerësojë pranimin ose jo të kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, respektimi me analogji edhe i kushteve ligjore, që parashikohen në nenin 29 të Ligjit nr. 49/2012. Konkretisht nevojitet të arsyetohet domosdoshmërisht dhe qartësisht se:

- ekziston dyshimi i arsyeshëm, mbi mundësinë e ardhjes së një dëmi të rëndë të pariparueshëm dhe të atëçastshëm për kërkuesin, për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;
- (nuk) cenohet rëndë interesi publik.

10. Këto kushte ligjore duhet të interpretohen rast pas rasti dhe në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes, duke garantuar se pranimi nga gjykata i kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në varësi të iniciuesit të kërkesës (subjekt apo organ publik) cenon rëndë ose jo interesin publik.

11. Pra, Gjykata e Lartë, në bazë dhe për zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, për pranimin e një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të duhet të konkludojë nëse ka rekurs të ushtruar, nëse ka argumente konkret ligjorë dhe/apo prova të palës kërkuese që bëjnë të bazuar pretendimin për ekzistencën e një dëmi të menjëhershëm dhe të riparueshëm që mund të pasjellë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më tej eventualisht mund të parashtruhet edhe garancia e ofruar dhe provat respektive të saj. Në këtë kuptim argumentet e parashtruara të palës kërkuese duhet të jetë konkrete dhe të referuara edhe në fakte dhe prova që vërtetojnë ekzistencën e tyre. Mungesa në kërkesën e paraqitur e këtyre argumenteve ligjore passjell mospranimin e kërkesës për pezullim.

12. Së pari, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë konstaton se nga ana e kërkuesit është bërë rekurs ndaj vendimit nr. 1594, datë 23.05.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit, si kushti që e legjitimon këtë subjekt për paraqitjen e kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të formës së prerë.

13. Së dyti, ky Kolegj konstaton se kërkesa e paraqitur nga pala e paditur, Shkolla e Mesme e Ndërtimit “Karl Gega”, Tiranë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 858 (852), datë 26.02.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. 1594, datë 23.05.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit, nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 479 të Kodit të Procedurës Civile.

14. Në kërkesën e paraqitur prej tij, kërkuesi parashtron një shkak gjenerik, pasojat e rënda financiare që do të paraqiste për të ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit, pa dhënë shpjegime dhe argumente se cilat do të ishin këto pasoja konkrete financiare dhe se në

ç'mënyrë do të shkaktoheshin nga ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit. Kërkesa për pezullimin e ekzekutimit të një vendimi të formës së prerë duhet t'i referohet një shkaku konkret, i cili duhet të arsyetohet mjaftueshëm nga ana e kërkuarit.

15. Shkaku tjetër i parashtruar nga kërkuari, se vendimet e gjykatave janë dhënë në kundërshtim me ligjin procedural dhe material, nuk përbën një shkak pezullimi por lidhet me themelin e pretendimeve që mund të parashtrohen në rekurs dhe që, si të tilla, nuk mund të merren në shqyrtim në këtë fazë të procesit dhe me këtë kërkesë.

16. Në të njëjtën kohë, kërkuari nuk ka paraqitur asnjë provë në mbështetje të pretendimit të tij për dëmin e rëndë financiar. Ardhja e pasojave me natyrë financiare është një fakt i provueshëm. Për më tepër, referuar nenit 12 të Kodit të Procedurës Civile, pala që pretendon një të drejtë ka detyrimin të provojë faktet mbi të cilat ajo mbështet pretendimet e saj.

17. Për sa u parashtrua më sipër, kërkesa e paraqitur nga pala e paditur, Shkolla e Mesme e Ndërtimit "Karl Gega", Tiranë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 858 (852), datë 26.02.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. 1594, datë 23.05.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit, nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 479 të Kodit të Procedurës Civile.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, bazuar në nenin 1, pika 2, të ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" si dhe nenin 479 të Kodit të Procedurës Civile;

V E N D O S I

Mospranimin e kërkesës së paraqitur nga pala e paditur, Shkolla e Mesme e Ndërtimit "Karl Gega", Tiranë, për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 858 (852), datë 26.02.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. 1594, datë 23.05.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit.

Tiranë, më 18.05.2020

A N Ë T A R
Ilir PANDA

A N Ë T A R
Ervin PUPE

K R Y E S U E S
Sokol SADUSHI